




Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



RAPORTI VJETOR I PERFORMANCËS 2023

Prishtinë, Prill 2024





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



RAPORTI VJETOR I PERFORMANCËS 2023

Përmbajtja

Fjalori i shprehjeve	3
Fjala e Auditorës së Përgjithshme	4
Vizioni, Misioni Dhe Vlerat	8
Baza e Raportit të Performancës	18
Kapitull I - Korniza ligjore dhe Qeverisja e Brendshme	20
1. Pavarësia dhe Korniza ligjore	21
1.1. Pavarësia institucionale.....	21
1.2. Mandati	22
Kapitull II - Qeverisja e brendshme dhe etika	24
2.1. Planifikimi strategjik dhe operativ.....	25
2.2. Mjedisi i kontrollit organizativ	27
2.3. Komunikimi i brendshëm.....	28
Kapitulli III - Fushëveprimi, Cilësia e Auditimit dhe Raportimi	30
3.1. Cilësia e auditimit dhe raportimi.....	31
3.2. Auditimet e realizuara 2022/2023.....	33
3.3. Auditimet e planifikuara 2023/2024	35
3.4. Rezultatet e auditimit dhe adresimi i rekomandimeve të auditimit financiar dhe të pajtueshmërisë	37
3.5. Auditimet e performancës	40
3.6. Kontrolli i cilësisë	54
3.7. Bashkëpunimi me organet e sundimit të ligjit	56
Kapitulli IV - Menaxhimi Financiar dhe Administrativ	58
4.1. Menaxhimi financiar	59
Kapitulli V - Burimet Njerëzore	66
5.1. Burimet Njerëzore	67
5.2. Zhvillimi profesional dhe trajnimi i personelit.....	69
5.3. Shërbimet e përbashkëta	73
5.4. Teknologjia informative	74
5.5. Prokurimi.....	75
Kapitulli VI - Komunikimi dhe Bashkëpunimi me Palët e jashtme	76
6.1. Komunikimi dhe bashkëpunimi me palët e interesit.....	77
6.2. Bashkëpunimi me Kuvendin e Republikës së Kosovës	78
6.3. Bashkëpunimi ndërkombëtar me ISA-të partnere dhe Marrëveshjet Bilaterale.....	80
6.4. Vlerësimet për ZKA-në nga palët e jashtme për vitin 2023	87
6.5. Komunikimi me mediat, qytetarët, organizatat e shoqërisë civile, donatorët dhe palë të tjera	88
6.6. Bashkëpunimi ndërkombëtar me ISA-të partnere, Marrëveshjet Bilaterale dhe pjesëmarrja në konferenca e punëtori ndërkombëtare	92
Kapitulli VII - Llogaridhënia dhe aktivitetet e vitit 2023.....	98
7.1. Llogaridhënia e ZKA-s	99
7.2. Aktivitetet gjatë vitit 2023.....	99
Shtojca I. AUDITIMET PËR SEZONIN 2022/23 DHE 2023/24	102
Shtojca II. PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË ZKA-SË PËR VITIN 2022.....	108

FJALORI I SHPREHJEVE

AB	Auditori i Brendshëm
AP	Auditori i Përgjithshëm
BE	Bashkimi Evropian
BK	Buxheti i Kosovës
EUROSAI	Organizata Evropiane e Institucioneve Supreme të Auditimit
INTOSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit (ONISA)
ISA	Institucioni Suprem i Auditimit
KA	Komiteti i Auditimit
KIDP	Korniza e INTOSAI-t për Deklaratat Profesionale
KBT	Komisioni për Buxhet, Punë dhe Transfere
KMFP	Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike
NP	Ndërmarrje Publike
OB	Organizata Buxhetore
OSHC	Organizatrat e Shoqërisë Civile
PFV	Pasqyrat Financiare Vjetore
RVP	Raporti Vjetor i Performancës
RVA	Raporti Vjetor i Auditimit
RFV/BK	Raporti Financiar Vjetor i Buxhetit të Kosovës
RTK	Radio Televizioni i Kosovës
SIMFK	Sistemi Informativ për Menaxhimin e Financave të Kosovës
SNA	Standardet Ndërkombëtare të Auditimit
SNAO	Zyra Kombëtare e Auditimit të Suedisë
SNISA	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit
SITA	Sistemin Informativ i Teknologjisë së Auditimit
TI	Teknologjia Informative
ZKA	Zyra Kombëtare e Auditimit

FJALA E AUDITORES SË PËRGJITHSHME



Vlora Spanca
Auditore e Përgjithshme

Raporti Vjetor i Performancës përmban aktivitetet e kryera të Zyrës Kombëtare të Auditimit gjatë vitit 2023. Shpalos progresin e arritur dhe nivelin e përgjithshëm të performancës karshi detyrimeve dhe mandatit kushtetues dhe ligjor që ka Auditori i Përgjithshëm dhe Zyra e tij. Po ashtu, përmban informacione dhe shpjegime për mënyrën se si janë shfrytëzuar burimet e besuara për kryerjen e proceseve audituese dhe të tjera brenda Institucionit.

Ne vazhduam të mbajmë një nivel dinamik dhe gjithëpërfshirës të mbulueshmërisë me auditime, gjithmonë në përputhje me pritjet e Kuvendit dhe Taksapaguesve tanë. Në epiqendër të synimeve tona e kishim menaxhimin e mirë të parasë publike dhe mirëqenien e qytetarëve.

Në punën tonë, jemi kujdesur që auditimet të jenë vlerë e shtuar për çdo institucion që auditohet duke kontribuar kështu në rritjen e besimit tek Zyra jonë si një mekanizëm që ka rol të drejtpërdrejtë në rritjen e përgjegjshmërisë në menaxhimin e fondeve publike. Ndikimi i auditimit në menaxhimin e mirë të financave publike është thelbësor për një administratë të përgjegjshme, transparente dhe llogaridhënëse. Për të përmirësuar këtë ndikim, në kemi ndërmarrë veprime të konsiderueshme në Planin tonë të auditimit, por edhe në zbatimin e tij në teren. Është rritur efikasiteti dhe ruajtur konsistenca në auditim. Kemi zhvilluar procese të reja në veçanti, më digjitalizimin e punës e kemi përforcuar metodologjinë e auditimit në mënyrë që rezultatet tona të jenë maksimalisht cilësore. Jemi fokusuar në zhvillimin e kapaciteteve institucionale në funksion të kryerjes së auditimeve efektive, si dhe bashkëpunimin cilësor me palët e interesit.

Është e rëndësishme që institucionet publike dhe auditorët të krijojnë një bashkëpunim të ngushtë dhe të pandërprerë. Është e nevojshme të ndërmerren masa për zbatimin e rekomandimeve të auditimit, dhe për të inkurajuar një kulturë të përgjegjshme në menaxhimin e financave në administratën publike.

Aktivitetet tona audituese janë zhvilluar në harmoni me Planin Vjetor të Auditimit 2022/23, i miratuar nga ana ime dhe i dorëzuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Përveç auditimeve të detyrueshme të rregullsisë, janë kryer edhe auditime të performancës të konsideruara me interes të lartë për qytetarët dhe Kuvendin. Fokusi dhe zgjerimi i mbulueshmërisë në auditim është përqendruar gjithashtu në auditimet e institucioneve dhe ndërmarrjeve publike me peshë të lartë financiare të cilat nuk ishin audituar një kohë të gjatë nga auditimi shtetëror. Marrë parasysh rëndësinë dhe zhvillimin e hovshëm të teknologjisë së informacionit dhe nevojës për sigurinë e të dhënave dhe sistemeve të TI-së në tërësi, gjatë këtij viti janë kryer një numër i auditimeve të kësaj fushe të cilat konsiderohen me rëndësi shtetërore dhe strategjike.

Për të nxitur përmirësimin e menaxhimit dhe shfrytëzimit të fondeve publike, me efikasitet, efektivitet dhe më qëllim të arritjes së vlerës për para në vitin 2023 (që mbulojnë periudhën 2022) kemi dhënë 878 rekomandime.

Krahasuar me një vit më parë, rezulton se Institucionet publike kanë bërë përmirësime në cilësinë e raportimit financiar. Kjo e rrit besueshmërinë në Pasqyra Financiare dhe është tregues se llogaridhënia dhe transparenca është duke u promovuar. Ka zvogëlim të numrit të opinionëve të modifikuara tek trembëdhjetë Institucione qendrore dhe lokale. Ka pasur një përmirësim të opinionit të auditimit tek Ndërmarrjet publike, pavarësisht se edhe më tutje këto opinione nuk janë të dëshirueshme. Ndërsa, menaxhimi dhe zvogëlimi i humbjeve tek shumica e NP-ve kishte përmirësim të dukshëm për vitin 2022, por edhe zbatimi i rekomandimeve ishte më i lartë krahasuar me institucione të tjera.

Pavarësisht sfidave të mëtejme në lidhje me fusha të caktuara të menaxhimit të parasë dhe pasurisë publike, përmirësimet e ndodhura patjetër se i atribuohen përveç masave të ndërmarra nga krerët e institucioneve edhe ndikimit të drejtpërdrejtë që kanë pasur rezultatet dhe rekomandimet tona.

Bashkëpunimi me palët e interesit, posaçërisht me shoqëritë civile dhe qytetarët është avancuar, me qëllim të gjithëpërfshirës dhe rritjes së transparencës lidhur me menaxhimin e parasë publike. Gjatë vitit 2023, kemi vazhduar të informojmë Prokurorin e Shtetit dhe organet e tjera të hetuesisë në lidhje me elementet potenciale të veprave penale (mashttrimit dhe korrupsionit).

ZKA-ja është përfaqësuar në mekanizma dhe ngjarje të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare të karakterit profesional dhe të tjera në kuadër të organizatave të INTOSAI-t dhe EUROSAT-t për të rritur cilësinë e punës sonë.

Përbushja e detyrimit dhe mandatit tim te përcaktuar, nuk do të arrihej pa ndihmën e të gjitha palëve të interesit të përfshira në procese të caktuara, duke filluar, nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, Entitetet e audituara, shoqëria civile, partnerët vendor e ndërkombëtar. Prandaj, për bashkëpunimin konstruktiv të treguar shpreh mirënjohjen time të sigurtë dhe të stafit të ZKA-së ndaj Kuvendit të Republikës së Kosovës, përkatësisht (KMFB) për trajtimin me përkushtim dhe në mënyrë serioze te raporteve të auditimit dhe (KBPT) për mbështetjen e dhënë për të përbushur objektivat e ZKA-së. Rezultatet e Zyrës sonë dhe cilido progres i arritur, patjetër se i atribuohen gjithë stafit tim për punën e palodhur në kryerjen e detyrave me përkushtim dhe kompetencë të lartë.

Fuqishëm jam vendosur të avancojmë tutje cilësinë profesionale të Zyrës Kombëtare të Auditimit, ruaj pavarësinë institucionale, forcojë integritetin, transparencën dhe frymën ekipore duke synuar gjithmonë suksese maksimale me qëllim të ofrimit të informacioneve objektive dhe relevante për shpenzimin e parasë publike Kuvendit, qytetarëve dhe palëve të tjera të interesuara.

Me respekt,
Vlora Spanca
Auditore e Përgjithshme

Prishtinë, 2024

VIZIONI, MISIONI DHE VLERAT



VIZIONI

Institucion Suprem i Auditimit i besueshëm dhe model që i shton vlerë përdorimit të fondeve publike.



MISIONI

Nëpërmjet auditimeve cilësore ofrojmë siguri në shfrytëzimin e pasurive dhe parasë publike, me qëllim të përmirësimit të ofrimit të shërbimeve për qytetarë dhe rritjen e llogaridhënies publike.



VLERAT E ZYRËS KOMBËTARE TË AUDITIMIT (ZKA)

Pavarësia

Pavarësia nënkupton që i gjithë procesi i auditimit t'i nënshtrohet vetëm kërkesave të standardeve profesionale dhe të jetë jashtë ndikimit të palëve të treta. Pavarësia është elementi kryesor për të siguruar besimin e publikut dhe të Kuvendit të Kosovës, duke u ofruar atyre informacione të besueshme dhe të paanshme.

Profesionalizmi

ZKA udhëhiqet në veprimtarinë e saj audituese nga principet dhe standardet në kuadër të Kornizës së Deklaratave Profesionale të ONISA/INTOSAI dhe nga praktikat më të mira të vendeve tjera.

Integriteti

ZKA angazhohet për mishërimin e vlerave më të mira etike, profesionale dhe morale. Veprimtaria e auditimit kryhet në mënyrë të ndershme dhe jashtë çdo konflikti të interesit.

Transparenca

ZKA është organizatë e hapur dhe do t'i bëj publike të gjitha aktivitetet e saj të rëndësishme. Po ashtu do t'i ofroj publikut të gjerë informacionin e përfutur nga auditimi, në përputhje me rregullat ligjore dhe standardet profesionale. ZKA angazhohet që të promovoj transparencën edhe në subjektet e audituara, si një element i qeverisjes së mirë.

Fryma ekipore

Në ZKA procesi i auditimit kryhet në mënyrë profesionale dhe bashkëpunues në mes kolegëve në ekip dhe në nivele të ndryshme organizative, kështu promovojmë frymën ekipore si vlerë e shtuar për ZKA-në.

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Në vitin 2023, Zyra Kombëtare e Auditimit ka vazhduar përmbushjen e mandatit kushtetues dhe ligjor në ofrimin e informacioneve të pavarura dhe objektive tek Kuvendi i Kosovës dhe qytetarët lidhur me atë nëse institucionet publike kanë përdorur parane publike në pajtueshmëri me kërkesat ligjore dhe me efikasitet, efektivitet dhe në të mirë të qytetarëve.

Plani vjetor i Auditimit për sezonin 2022/2023 është përmbushur sipas parashikimeve të bëra. Kemi kryer 124 auditime financiare/pajtueshmërisë, si dhe të performancës dhe kemi publikuar raporte të auditimit. Duhet theksuar se në mungesë të Pasqyrave Vjetore Financiare dhe dëshmime tjera të auditimit, në 4 komunat e veriut të Kosovës, ZKA nuk ka mundur të kryej auditimet. Në anën tjetër, në këtë sezon auditues janë përfshirë institucione më vlerë më të lartë buxhetore dhe më komplekse (KEK-u dhe RTK për PVF, Trepça dhe KEK-u – performancës). Po ashtu, është kryer monitorimi i zbatimit të rekomandimeve, si dhe proceset e administrimit dhe menaxhimit të buxhetit dhe burimeve njerëzore. Ndërsa, vëmendje e theksuar i është kushtuar edhe komunikimit të brendshëm dhe palëve të jashtme të interesit.

Duhet theksuar se për përmirësimin e menaxhimit financiar/pajtueshmërisë dhe kontrollit, ZKA ka dhënë rekomandime përkatëse, përmes se cilave kemi ndikuar në:


- Rritjen e cilësisë dhe saktësisë së raportimeve financiare;
- Regjistrimin dhe përdorimin më efikas të pasurisë publike duke ndikuar në korrigjimin e regjistrave të pasurisë dhe rritjen e prezantimit të tyre në shifra dhjetëra milionëshe.
- Pronat të cilat janë përdorur ndër vite në mënyrë të paligjshme, tani administrohen në mënyrë më të arsyeshme dhe ligjore duke u dhënë në shfrytëzim palëve në sektorë të ndryshëm, me ç'rast, janë rritur edhe të hyrat buxhetore dhe
- Rritjen e transparencës në dhënien dhe monitorimin e subvencioneve, duke evituar dhënien e tyre pa kritere.

Ndërsa auditimet e performancës vlerësojnë se sa efektive po përdoren burimet publike dhe se si ato po kontribuojnë në mirëqenien e qytetarëve. Zyra Kombëtare e Auditimit që nga viti 2010 ka kryer auditime të tilla duke mbuluar 12 fusha¹. Këto auditime përveç që kanë ndikuar në përmirësimin e proceseve dhe operacioneve në menaxhimin më të mirë të financave publike, gjithashtu kanë promovuar një mirëqenie më të mirë të qytetarëve.

Po ashtu në kuadër të proceseve të saj operuese, ZKA çdo vit identifikon çështjet nga raportet e auditimit dhe vlerëson nëse ato kanë elemente për keqpërdorim ose mashtrim. Në vitin 2023 janë dërguar 51 raste dhe 2 raporte në tërësi që për ZKA-në janë konsideruar dëshmi me elemente potenciale për trajtim të mëtutjeshëm në Prokurorinë e Shtetit.

¹ Arsim dhe kulturë, bujqësi dhe ushqim, buxhet dhe shpenzim, drejtësi dhe siguri, ekonomi, energji, menaxhim, mirëqenie ekonomike dhe sociale, mjedis dhe siguri, prokurim publik, shëndetësi dhe teknologji e informacionit.

Rezultatet e punës audituese për vitin 2023



- **Auditimet Financiare dhe të Pajtueshmërisë** - Gjatë sezonit auditues 2022/2023 janë kryer 124 auditime për të cilat janë lëshuar raportet përkatëse të auditimit, të cilat përfshijnë:
 - 1 Raport Vjetor i Auditimit për Raportin Vjetor Financiar të Buxhetit të Kosovës për vitin fiskal 2022;
 - 86 raporte të auditimit për Organizatat Buxhetore;
 - 11 raporte të auditimit për Ndërmarrjet Publike dhe
 - 9 raporte të auditimit të projekteve (financuara nga donatorët-BB).

Fokusi kryesor i auditimeve financiare dhe të pajtueshmërisë ka qenë në cilësinë e raportimit financiar, efikasitetin dhe efektivitetin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, pajtueshmërinë e vendimeve të subjekteve të audituara me kornizën ligjore, si dhe çështjet të tjera që kanë të bëjnë me vlerën për para.

- **Auditimet e performancës**
 - 15 auditime të performancës.

Auditimet e performancës kanë mbuluar fushat me interes për qytetarët, Kuvendin e Kosovës dhe palët e tjera të interesit, me fokus në: barazi gjinore/sociale, shëndetësi, mjedis dhe siguri, zhvillim ekonomik dhe buxhet, prokurim publik,

teknologji të informacionit, etj. Në fushën e teknologjisë së informacionit, është kryer një auditim paralel me Kontrollin e Lartë të Shtetit të Shqipërisë i cili ka mbuluar sistemet e Ujësjetës të Tiranës dhe Prishtinës.

- **Auditimet e veçanta të pajtueshmërisë**

- 2 raporte të auditimit të pajtueshmërisë, informata të klasifikuara me nivel „E KUFIZUAR”,

Rezultatet Kryesore nga Raporti Vjetor i Auditimit për vitin 2022

Në auditimet e kryera janë nxjerrë në pah një numër dobësish në shumicën e organizatave buxhetore dhe entiteteve tjera në fushën e shpenzimeve, mbledhjes së parasë publike, menaxhimit të pasurisë publike dhe fusha të tjera, të cilat kanë rezultuar në menaxhim të dobët të fondeve buxhetore si dhe mos arritjen e vlerës për para.

Dobësitë kryesore të identifikuara gjatë auditimeve financiare dhe pajtueshmërisë, janë theksuar tek kryerja e transaksioneve dhe aktiviteteve në përputhje me kornizën ligjore, klasifikimi joadekuat i shpenzimeve, regjistrimi dhe menaxhimi i pasurive, raportimi tek detyrimet e pa paguara, procedurat e prokurimit dhe menaxhimi i kontratave, llogaritë e arkëtueshme dhe ato të pagueshme, si dhe fusha të tjera për të cilat janë bërë shpalosje më në detaje në brendi të këtij Raporti.

Krahasuar me një vit më parë rezulton se këtë vit Institucionet Publike kanë bërë përmirësime në cilësinë e raportimit financiar, kjo e rrit besueshmërinë në Pasqyra Financiare. Kemi zvogëlim të numrit të opinionëve të modifikuara tek shtatë (7) Institucione Qendrore dhe gjashtë (6) Institucione Lokale (komuna). Gjithashtu, edhe tek Ndërmarrjet Publike kemi një përmirësim të opinionit, nga 10 të kundërta që kishin pranuar vitin që shkoj këtë vit janë 7 më pak, pavarësisht se pothuajse të gjitha kanë opinionë të kualifikuar. Ndërsa, menaxhimi dhe zvogëlimi i humbjeve kishte përmirësim të dukshëm për vitin 2022, vetëm njëra nga to kishte trend rritës të humbjeve.


Pavarësisht sfidave të mëtejme në lidhje me fusha të caktuara të menaxhimit të parasë dhe pasurisë publike, përmirësimet e ndodhura patjetër se i atribuohen përveç masave të ndërmarra nga krerët e institucioneve edhe ndikimit që kanë pasur rezultatet dhe rekomandimet e Zyrës Kombëtare të Auditimit.

Zbatimi i rekomandimeve

Në raportet e auditimit për periudhën e vitit 2022 janë dhënë 571 rekomandime (institucione qendrore, të pavarura dhe lokale). Gjatë auditimit për vitin 2022 është vlerësuar zbatimi i rekomandimeve të vitit paraprak. Sipas këtij vlerësimi 49% e rekomandimeve ishin zbatuar plotësisht, 9% pjesërisht dhe 42% nuk janë zbatuar.

Në NP, në raportet e auditimit për periudhën e vitit 2022 janë dhënë 134 rekomandime. Gjatë auditimit për vitin 2022 është vlerësuar zbatimi i rekomandimeve të vitit paraprak. Sipas këtij vlerësimi 58% e rekomandimeve ishin zbatuar plotësisht, 39% ishin zbatuar pjesërisht dhe 3% nuk janë zbatuar. Zbatimi i rekomandimeve ishte më i lartë krahasuar me institucione të tjera.

Menaxhimi financiar dhe administrativ i ZKA-së, në vitin 2023



Buxheti final ishte i ndarë në katër kategori ekonomike, si:

Paga dhe shtesa	2,172,624€
Mallra dhe Shërbime	765,021€
Shërbime komunale	40,000€
Investime kapitale	74,000€

Në fund të vitit 2023



163 punonjës



79%
personel auditues
(përfshirë pozitat në
kategorinë drejtuese)



21%
personel të mbështetjes
profesionale
(përfshirë pozitat në
kategorinë drejtuese)

ZKA ka investuar në zhvillimin e kapaciteteve profesionale të stafit auditues për të siguruar që ata të jenë në hap me zhvillimet ndërkombëtare në fushën e financave, auditimit dhe fushave tjera relevante.

Komunikimi dhe përfaqësimi me palët e jashtme

ZKA në vitin 2023 ka zhvilluar komunikim efektiv me publikun si dhe ka qenë pjesë aktive në shumë takime, punëtori dhe konferenca brenda dhe jashtë vendit duke kultivuar një bashkëpunim të ngushtë me partnerët si në nivel kombëtar ashtu edhe në atë ndërkombëtar.

Në vitin 2023 fokus të veçantë i kemi dhënë edhe bashkëpunimit dhe partneritetit me mediat, Organizatat e Shoqërisë Civile, si dhe komunikimit me qytetarë. Ky komunikim është avancuar përmes konferencave, takimeve si dhe aktiviteteve të ndryshme. Zyra Kombëtare e Auditimit gjatë vitit 2023 është angazhuar në mënyrë aktive në avancimin e bashkëpunimit ndërkombëtar për të shkëmbyer praktikat më të mira dhe për të nxitur bashkëpunimin me homologët në nivel regjional dhe global. Në aspektin ndërkombëtar është avancuar bashkëpunimi me Institucionet Supreme të Auditimit përmes takimeve, punëtorive e aktiviteteve të tjera në kuadër të EUROSAT-t dhe INTOSAT-t, si dhe në nivel regjional në kuadër të Rrjetit të Institucioneve Supreme të Auditimit të vendeve kandidatë dhe kandidatëve të mundshme për anëtarësim në BE. Bashkëpunimi me Kuvendin e Republikës së Kosovës, është intensifikuar kryesisht përmes punës me Komisionin për Mbikëqyrje të Financave Publike (KMFP) dhe Komisionin për Buxhet, Punë dhe

Transfere (KBPT). Gjatë vitit 2023 (KMFP) ka shqyrtuar 32 raporte të auditimit dhe KBPT ka shqyrtuar 1 raport të auditimit të performancës për të cilët ka dhënë edhe rekomandime për përmirësim për Institucionet e audituara.

Për të përforcuar rolin dhe ndikimin e saj, në vitin 2023 ZKA ka rritur bashkëpunimin me mekanizma të ndryshëm ndërkombëtar dhe vendor, si: EUROSAI, UN Women, KLSH, USAID, KRRPP, MFPT, DEMOS dhe Prokurorin e Shtetit.

Bashkëpunimi më organet e sundimit të ligjit, gjatë këtij viti ka rezultuar me dërgimin e 51 rasteve dhe 3 raporte në tërësi me elemente potenciale të veprave penale, mashtrimit dhe korrupsionit në Prokurori të Shtetit.

Vlerësimet për ZKA-në nga palët e jashtme për vitin 2023 - Performanca e ZKA-së për këtë vit ka qenë subjekt i vlerësimeve të disa mekanizmave ndërkombëtar e vendor karshi opinionit publik, nivelit profesional dhe zbatimit të standardeve ndërkombëtare të auditimit. Këto vlerësime Zyrën tonë e kanë renditur në nivele të larta pozitive.

Raporti i rishikimit nga SIGMA-2023 - Vlerësimi më domethënës ka qenë i rishikimit kolegial (peer review) i kërkuar nga Kuvendi i Kosovës (KMFP) dhe i kryer nga ekspertë të pavarur të SIGMA-s, në shtator 2023. Ky rishikim, në bazë të analizave dhe shqyrtimeve të punës së ZKA-së, posaçërisht për auditimet e 2022 ka vlerësuar se ZKA është duke përfomuar në përputhje të plotë me standardet ndërkombëtare të auditimit dhe praktikat e mira evropiane. Rezultati i këtij rishikimi është vlerësimi më pozitiv i mundshëm ku vlerësuesit potencojnë se ZKA ka ndërmarr veprime serioze në zhvillimin dhe përmbushjen e pritshmërisë së kornizës së deklaratave profesionale të INTOSAI për të ndërtuar një institucion të pavarur dhe të besueshëm.

Barometri Ballkanik rendit ZKA-në si institucionin më të besuar në nivel rajonal- Këshilli për Bashkëpunim Rajonal në raportin e publikuar për vitin 2023 në lidhje me nivelin e besueshmërisë në institucionet publike tregon se Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës gëzon besimin më të lartë në nivel rajonal, me 55% krahasuar me Institucionet Supreme të Auditimit të vendeve të tjera të rajonit.

Po ashtu, sipas vlerësimit të Sistemit të Integritetit Kombëtar në Kosovë, për vitin 2023 i realizuar nga Instituti Demokratik i Kosovës, Zyra Kombëtare e Auditimit është renditur institucioni me nivelin më të lartë të integritetit (me 83.3 nga 100 pikë).

Këto rezultate janë një dëshmi dhe konfirmim i angazhimit të palodhur, transparencës dhe standardeve të larta etike dhe profesionale në të cilat ZKA-ja mbështet punën e saj.

Baza e Raportit të Performancës

Mbështetur në nenin 14 të Ligjit Nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës, Auditori i Përgjithshëm i dorëzon Kuvendit Raportin Vjetor të Performancës rreth aktiviteteve të Zyrës Kombëtare të Auditimit.

Ushtrimi i mandatit kushtetues dhe ligjor i ZKA-së, bazohet në strukturën e Kornizës së Matjes së Performancës së Institucioneve Supreme të Auditimit (ISA). Kjo kornizë u ofron ISA-ve mundësinë që të vlerësojnë nivelin e performancës së tyre kundrejt Standardeve Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA).

Kjo kornizë ka për qëllim që të kontribuojë në përmirësimin e mëtejshëm në zhvillimin e kapaciteteve të ISA-ve përmes menaxhimit dhe promovimit të matjes së performancës, si dhe identifikimin e mundësive për të forcuar dhe monitoruar performancën dhe llogaridhënien e ISA-ve.

Korniza e Matjes së Performancës së ISA-ve, si dokument standard i INTOSA-it, përmban gjashtë fusha kryesore:

I.	Pavarësia dhe Korniza Ligjore
II.	Qeverisja e Brendshme dhe Etika
III.	Fushëveprimi, Cilësia e Auditimit dhe Raportimi
IV.	Menaxhimi financiar dhe administrativ
V.	Burimet njerëzore
VI.	Komunikimi dhe Bashkëpunimi me Palët e Jashtme
VII.	Llogaridhënia dhe aktivitetet e vitit 2023

Andaj, edhe Raporti Vjetor i Performancës së ZKA-së është hartuar dhe shpалosur në përputhje me fushat kryesore të kësaj kornize.

Korniza ligjore dhe Qeverisja e Brendshme

01

Pavarësia dhe qeverisja e brendshme reflektojnë përmbushjen e mandatit kushtetues e ligjor me qëllim të kryerjes së auditimeve cilësore në përputhje me SNISA.

1. Pavarësia dhe Korniza ligjore

Kjo fushë mbulon mandatin ligjor dhe pavarësinë e institucionit të Auditorit të Përgjithshëm (AP)². Përveç kornizës ligjore të vendit, Kushtetutës dhe ligjeve relevante, bazë e parimeve themelore të ISA-ve për këtë fushë janë: Deklarata e Limës (INTOSAI-P 1) dhe Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e ISA-ve (INTOSAI-P 10). Elementet tregues që ZKA-ja ka aplikuar për këtë fushë janë: pavarësia institucionale dhe mandati.

1.1. Pavarësia institucionale

Kushtetuta e Republikës së Kosovës e përcakton se Auditori i Përgjithshëm është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar në vend. Kompetencat themelore të AP-së janë përcaktuar me Kushtetutë dhe janë definuar më tej me ligjin e veçantë, Ligjin nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit (Ligji i ZKA-së), i cili ka hyrë në fuqi në qershor të vitit 2016. Sipas Kapitullit XII (dymbëdhjetë) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe Nenit 13 të Ligjit Nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit, Auditori i Përgjithshëm duhet të ketë pavarësi financiare, menaxheriale dhe administrative si dhe burime të mjaftueshme njerëzore, materiale dhe financiare me qëllim të përmbushjes së mandatit të saj Kushtetues.

Sipas legjislacionit në fuqi, AP ka liri të plotë veprimi në kryerjen dhe ushtrimin e funksioneve dhe kompetencave për të zbatuar mandatin e tij dhe është i pavarur në organizimin dhe menaxhimin e ZKA-së.

Gjatë vitit 2023, nuk janë shënuar raste të ndonjë ndërhyrjeje nga palët e treta në punën e ZKA-së dhe AP-së, duke ushtruar e lirë dhe pa ndikim në rolin dhe veprimtarinë të përcaktuar me kushtetutë dhe me ligj.

² Në këtë Raport, institucionit të Auditorit të Përgjithshëm do t'i referohemi edhe si Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA).

Ligji aktual për ZKA-në ka nevojë për ndryshim për sa i përket të drejtës së Ekzekutivit/Qeverisë për të modifikuar kërkesën buxhetore të ZKA-së³. Në lidhje me këtë, AP-ja ka iniciuar ndryshimin e Ligjit qysh në vitin 2022. Ky ndryshim ka për qëllim përshtatjen e tij më standardet ndërkombëtare të institucioneve supreme të auditimit. Në lidhje me këtë Projektligjin e propozuar, Qeveria e ka vendosur në programin legjislativ për vitin 2024.

1.2. Mandati

Ky tregues vlerëson autoritetin operacional të ZKA-së, të përcaktuar në Kornizën Ligjore. Dimensionet për të vlerësuar këtë tregues janë: mandati i mjaftueshëm dhe i gjerë, qasja në informata, e drejta dhe detyrimi për të raportuar.

Kushtetuta e vendit dhe Ligji i veçantë, i japin AP-së mandat të gjerë të auditimit të të gjitha subjekteve të sektorit publik në Kosovë. Në bazë të këtij mandati, Auditori i Përgjithshëm ka të drejtë të kontrollojë të gjitha aktivitetet, programet dhe projektet financiare, administrative dhe të tjera të menaxhuara nga institucionet publike, përfshirë procesin dhe të ardhurat nga shitja e aseteve, privatizimeve dhe koncesioneve. AP kryen auditime të rregullsisë së Buxhetit të Kosovës dhe të gjitha organizatave buxhetore, si dhe ndërmarrjeve publike. Gjithashtu, kryen auditime të performancës ose llojeve tjera të auditimeve, për të vlerësuar efikasitetin, efektivitetin dhe/ose ekonomikitetin e një aspekti të veçantë të operacioneve në tërësi ose të pjeshme të ndonjë institucioni, programi ose aktiviteti.

Megjithatë, disa ligje të veçanta kanë krijuar paqartësi për auditimin e disa institucioneve publike që çështjen e auditimit e kanë trajtuar në mënyrë tjetër krahasuar me dispozitat kushtetuese dhe ato të Ligjit për AP-në⁴. Për më tepër, Ligji për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim nuk është harmonizuar me Kushtetutën, Ligjin për AP-në dhe Ligjin për Ndërmarrjet Publike (NP), lidhur me mandatin e AP-së për auditimin e NP-ve dhe afatet kohore për raportim financiar. Edhe Ligji për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës çështjen e auditimit nuk e ka përcaktuar në frymën e Kushtetutës së Kosovës.

3 Në bazë të praktikave të mira ndërkombëtare (Deklarata e Limës dhe Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e ISA-ve) për të siguruar pavarësinë e plotë financiare, rekomandohet që buxheti i ISA-ve të trajtohet nga Kuvendi, jo nga Qeveria.

4 BQK – Banka Qendrore e Kosovës; AKI – Agjencia Kosovare e Inteligjencës, dhe FKPK – Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës.

AP-ja, në përputhje me autorizimin kushtetues e ligjor, ka **qasje të pakufizuar** në të gjitha informatat dhe shpjegimet, që vlerëson se i nevojiten për qëllime të auditimit. Gjatë periudhës raportuese, bashkëpunimi me subjektet e audituara ka qenë korrekt dhe nuk është shënuar ndonjë rast i kufizimit të qasjes për auditorët. Zyrtarëve të autorizuar nga AP-ja u është mundësuar që në çdo kohë të arsyeshme të hyjnë dhe të qëndrojnë në objektet e organizatave buxhetore të audituara.

AP-ja e ka autoritetin kushtetues që në mënyrë të pavarur të raportojë në Kuvend gjetjet e çdo viti. Para datës 31 gusht 2023, AP-ja ka prezantuar para deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës Raportin Vjetor të Auditimit për vitin fiskal 2022. Mbi këtë bazë, AP-ja ka ftuar Kuvendin e Republikës së Kosovës që të kërkojë rritjen e përgjegjësisë llogaridhënëse nga institucionet e audituara në mënyrë që të ndërmarrin veprime të menjëhershme për zbatimin e rekomandimeve dhe adresimin e mangësive të raportuara. Sikurse edhe gjatë viteve paraprake, ZKA-ja i ka bërë publike të gjitha raportet e auditimit.

**Qeverisja e
brendshme dhe etika**

02

Qeverisja e brendshme dhe etika, përfshinë treguesit si: plani strategjik dhe operativ, mjedisi i kontrollit organizativ dhe komunikimi i brendshëm.

2.1. Planifikimi strategjik dhe operativ

ZKA-ja zhvillon veprimtarinë e saj bazuar në planin strategjik, planin operativ dhe planin vjetor të auditimit.

- **Planifikimi Strategjik** - Plani Strategjik 2023-2026 është finalizuar në janar të vitit 2023, mbi këtë bazë është hartuar plani operacional/veprimi për monitorim dhe raportim për zbatimin e Planit Strategjik. Në cilësinë e përcjelljes së objektivave strategjike është hartuar raporti gjashtëmuor për zbatimin e planit të veprimit/monitorimit të Strategjisë për ZKA-në, si dhe Raporti Vjetor mbi zbatimin e dokumentit të Strategjisë për periudhën kohore janar 2023/janar 2024.

Për këtë periudhë kohore ZKA ka ndërmarr të gjitha veprimet e nevojshme për arritjen e qëllimeve strategjike, si: përmbushjen e misionit kushtetues e ligjor, duke kryer auditime relevante në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit, zhvillimin e kapaciteteve institucionale në funksion të kryerjes së auditimeve efektive, po ashtu dhe për bashkëpunimin cilësor me palët e interesit.

Për periudhën 1 vjeçare, nga 60 aktivitetet e planifikuara: 26 janë zbatuar plotësisht, 31 pjesërisht ose janë në zbatim e sipër dhe 3 nuk janë zbatuar, ngase ndër veprohet me palët e jashtme. Akomodimi i stafit në objekt në pronësi publike, Miratimi i ligjit të ZKA-së, si dhe Mekanizmi i krijuar që gjatë dëgjimeve buxhetore të organizatave, të merren për bazë raportet e auditimit të ZKA-së në hartimin e ligjit për buxhet janë aktivitetet të cilat ende nuk kanë arritur të adresohen.

Auditorja e Përgjithshme ka vlerësuar se është e rëndësishme që ZKA-ja t'i nënshtrohet vlerësimit të performancës sipas Kornizës së INTOSAI-t për Matjen e Performancës së Institucioneve Supreme të Auditimit (ISA), dhe në tetor 2021, ka marrë vendimin për të kryer vetëvlerësimin e performancës së institucionit sipas kësaj kornize. Mbi këtë bazë në vitin 2023 ekipi përkatës ka finalizuar procesin e vlerësimit, nën mbikëqyrjen e drejtpërdrejtë të zyrtarëve të Iniciativës për Zhvillim të INTOSAI-t.

Në vitin 2022 me kërkesë të Auditorës së Përgjithshme dhe me aprovim të Kuvendit të Kosovës (KMFP), ekspertët e pavarur të SIGMA-s në shtator 2023 kanë kryer rishikimin dhe vlerësimin profesional të punës së ZKA-së në disa fusha si: pavarësinë dhe kornizën ligjore, menaxhimin dhe qeverisjen, metodologjinë e procesit të auditimit, raportimin dhe cilësinë e tij në përputhje me standardet ndërkombëtare të auditimit dhe praktikat e mira evropiane, planifikimin strategjik dhe performancën organizative. Rezultati i këtij rishikimi nga SIGMA është vlerësuar pozitiv ku potencojnë se ZKA ka ndërmarr veprime serioze në zhvillimin dhe përmbushjen e pritshmërisë së kornizës së deklaratave profesionale të INTOSAI për të ndërtuar një institucion të pavarur dhe të besueshëm.

Sigurisht, raporti i rishikimit nga SIGMA dhe ai i vetëvlerësimit të performancës do i shërbejnë Auditorit të Përgjithshëm që për planifikimet e ardhshme të ndërmarrë masa përmirësuese/avancuese, me qëllim të rritjes së ndikimit të rezultateve të auditimit si dhe zhvillimit të kapaciteteve të ZKA-së.

- **Plani operativ vjetor** – ZKA edhe në 2023 ka vazhduar me përmbushjen e të gjitha kërkesave dhe afateve ligjore në kryerjen e auditimeve. Duhet të theksohet se përkundër sfidave veçanërisht të aspektit të mungesës së burimeve njerëzore në përputhje me planin vjetor 2022/2023, janë bërë përpjekje maksimale që të gjitha auditimet e planifikuara të përfundohen me kohë, gjë që ky objektivi është arritur me efikasitet dhe efektivitet maksimal.
- **Plani vjetor i auditimit** - AP-ja ka miratuar Planin Vjetor të Auditimit 2023/24, i cili përfshinë sezonin auditues për periudhën 1 shtator 2023 deri më 31 gusht 2024. ZKA harton çdo vit, Planin Vjetor të Auditimit, i cili përmban informata për objektivat e ZKA-së, llojet e auditimeve, procesin e auditimit, organizimin, buxhetin dhe burimet njerëzore, dhe auditimet e projekteve. Gjatë hartimit të Planit Vjetor janë marrë në konsideratë përmbushja e obligimeve kushtetuese e ligjore për auditime të rregullsisë, mbulueshmëria sa më e gjerë me auditime të performancës, duke i dhënë fokus rëndësisë dhe aktualitetit të çështjeve të caktuara. Planifikimi i këtyre auditimeve është bërë duke pasur parasysh edhe kapacitetet njerëzore dhe financiare që ka pasur në dispozicion ZKA-ja. Plani i është dorëzuar KMFP-së për informim në fillim të sezonit auditues në përputhje me kërkesat ligjore.

2.2. Mjedisi i kontrollit organizativ

Bazuar në kërkesat që burojnë nga ligji, rregulloret e brendshme dhe SNISA-të, ZKA-ja, ajo ka të përshtatur strukturën organizative e cila është në funksion të krijimit të një sistemi të kontrollit të brendshëm që ofron siguri të arsyeshme se operacionet e institucionit menaxhohen në mënyrë efektive dhe efikase.

- **Kodi i Etikës** i cili rishikohet në periudha të shpeshta kohore është në harmoni të plotë me Kodin e Etikës të INTOSAI. Në këtë kod janë rregulluar çështja e integritetit, pavarësisë, objektivitetit, kompetencës profesionale, konfidencialitetit dhe konfliktit të interesit. Kodi zbatohet për të gjithë punonjësit e ZKA-së. ZKA ka hartuar procedura të shkruara, të cilat ndër tjera kërkojnë që i gjithë personeli dhe palët e autorizuara për të kryer punë për ZKA-në, të pajtohen me kërkesat etike, duke nënshkruar dhe respektuar Kodin e Etikës dhe Deklaratën e Pavarësisë Profesionale. Mbi këtë bazë është themeluar edhe Komisioni për çështje etike, i cili përcjell zbatimin e Kodit të Etikës dhe jep konkluzione për çdo rast/ kërkesë nga stafi lidhur me çështjet etike.
- **Sistemi i kontrollit të brendshëm** - Kontrolli i brendshëm për aktivitetet jo audituese kryhet nëpërmjet rregullave dhe procedurave të menaxhimit financiar dhe kontrollit. Në ZKA zbatohen: ndarja e detyrave, delegimi, autorizimi, mbikëqyrja dhe auditimi i brendshëm.

ZKA-ja ka hartuar dokumentin për menaxhimin e rreziqeve, i cili zbatohet duke u bazuar në objektivat e vendosura me dokumentet strategjike të saj dhe kornizën tjetër të aplikueshme për menaxhimin financiar dhe kontrollin (MFK). Për më tepër, ZKA-ja ka të dizajnuar një strukturë funksionale të kontrolleve të brendshme. Të gjitha komponentët e kontrolleve operojnë në mënyrë efektive, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve.

- **Auditimi i brendshëm** - ZKA ka një auditor të brendshëm (AB) në kuadër të Njesisë që i raporton drejtpërdrejtë AP-së dhe ka Komitetin e Auditimit i cili është i plotë dhe funksional. Metodologjia e bazuar në rrezik përdoret për planifikim të auditimit me qëllim që ti ofrohet siguri AP-së se proceset e menaxhimit të rrezikut, qeverisjes dhe kontrollit të brendshëm në ZKA funksionojnë në mënyrë efektive. Në vitin 2023, AB ka dorëzuar AP-së pesë (5) raporte të auditimit, në temat lidhur me: “Aktivitetet e Prokurimit”, “Menaxhimi i Aktiviteteve të Trajnimit dhe Zhvillimit Profesional”, “Zbatimi i Rekomandimeve nga raporti “ Menaxhimi i pasurisë jo financiare në

ZKA”, “Zbatimi i rekomandimeve nga raporti Menaxhimi i Logjistikës “, “Menaxhimi i Shpenzimeve dhe procesi i buxhetimit në ZKA”. Komiteti i Auditimit (KA) kryen funksionin e tij në përputhje me rregullativën në fuqi. Me qëllim të mbështetjes së AP-së si dhe përmirësimit të qeverisjes në ZKA, KA gjatë vitit 2023 ka mbajtur katër takime, si dhe ka hartuar raportin vjetor, në të cilat janë shqyrtuar raportet e AB-së dhe opinioni i auditorit të jashtëm për PFV.

2.3. Komunikimi i brendshëm

Komunikimi i brendshëm efektiv i mundëson punonjësve të ZKA-së në të gjitha nivelet të koordinojnë kërkesat dhe propozimet e ndryshme për çështjet që lidhen me punën audituese, si dhe për çështje administrative brenda institucionit.

Menaxhmenti i ZKA-së mban takime të rregullta javore, të dokumentuara me procesverbale. Vendimet e nxjerra dokumentohen dhe i komunikohen stafit në varësi të rëndësisë dhe nevojës për të promovuar transparencën. Këto dokumente janë të qasshme për të gjitha nivelet organizative. Ekziston mekanizëm për shpërndarjen e informacionit tek stafi nëpërmjet një rrjeti të brendshëm të komunikimit elektronik, përmes së cilit menaxhmenti i ZKA-së i informon rregullisht punonjësit mbi çështjet kryesore të lidhura me organizatën.

Puna audituese dokumentohet dhe raportohet përmes organizimit dhe mirëmbajtjes së dosjeve përkatëse dhe sistemit informativ për menaxhimin e auditimeve (SITA), i cili ka rezultuar me rritjen e transparencës dhe kontrollin e cilësisë në kryerjen e funksionit auditues.

Fushëveprimi, Cilësia e Auditimit dhe Raportimi

03

Fushëveprimi/cilësia e auditimeve, raportimi i rezultateve të auditimeve, adresimi i rekomandimeve nga subjektet e audituara, si dhe kontrolli i cilësisë janë komponentët që trajtohen në këtë kapitull.

3.1. Cilësia e auditimit dhe raportimi

ZKA-ja kryen auditimet në pajtueshmëri me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit dhe praktikave të mira. Po ashtu, për të siguruar cilësinë e auditimeve ka të hartuar doracakët e auditimit financiar me qasje të kombinuar me pajtueshmëri, doracakun për auditime të performancës dhe prokurimit si dhe doracakun për auditime të teknologjisë së informacionit. Për të siguruar se cikli i llogaridhënies lidhur me cilësinë në auditim përmbyllet siç duhet, ka të hartuar edhe udhëzuesin për menaxhimin e cilësisë në auditim. Në bazë të ligjit të ZKA-së, të gjitha raportet e auditimit bëhen publike në web-faqen zyrtare.

Në përputhje me mandatin ligjor dhe fushëveprimin, ZKA kryen këto lloje të auditimeve:

- Auditime financiare dhe të pajtueshmërisë të organizatave buxhetore (bazuar në sistemin e parasë së gatshme) dhe të ndërmarrjeve publike (bazuar në sistemin akruar) dhe
- Auditime të performancës (prokurimit dhe teknologjisë së informacionit).

Auditimi Financiar dhe i Pajtueshmërisë - përfshinë auditimin e PFV-ve të institucionit me qëllim të vlerësimit nëse raportet financiare:

- janë të besueshme dhe pasqyrojnë rezultatet e realizimit të buxhetit në mënyrë të drejtë;
- vlerësimin nëse menaxhmenti iu ka përmbajtur ligjeve dhe akteve nënligjore të zbatueshme dhe nëse fondet janë përdorur për qëllimet e synuara;
- vlerësimin e funksionimit të sistemit të menaxhimit financiar, funksionet e auditimit të brendshëm dhe sistemet e kontrollit të brendshëm.

Objektivat e auditimit financiar dhe të pajtueshmërisë përkufizohen si siguri e arsyeshme, e cila i ofrohet shfrytëzuesve të pasqyrave financiare, nëse informatat në pasqyrat financiare të audituara janë në tërë kuptimin material të vërteta dhe të drejta dhe nëse transaksionet e raportuara në ato pasqyra janë kryer në pajtueshmëri me autoritetet⁵.

Sipas SNISA-ve të përditësuara, auditimet e rregullsisë së PVF-ve janë auditime financiare dhe auditime të pajtueshmërisë (qasje e kombinuar), prandaj në vazhdim po japim përkufizimet për objektivat e llojeve të auditimeve.

- **Objektivi i auditimit financiar** të pasqyrave financiare është të rrisë nivelin e besimit tek përdoruesit e pasqyrave financiare. Kjo arrihet përmes dhënies së opinionit nga ana e auditorit nëse pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kornizën raportuese në fuqi, si dhe të ofrojë siguri të arsyeshme se informacioni financiar në raportin vjetor financiar është i vërtetë, i drejtë dhe konsistent me Kornizën për Raportim Financiar dhe Kornizën Rregullative.
- **Objektivi i auditimit të pajtueshmërisë** është që të informojë përdoruesit nëse entitetet publike të audituara respektojnë vendimet e Kuvendit, ligjet, aktet legjislativë, politikat, kodet, praktikat e mira, si dhe të ofrojë siguri se proceset raportuese të kontabilitetit/financiar dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me autoritetet.

Qëllimi gjithëpërfshirës i auditimit financiar dhe i pajtueshmërisë është të rritet niveli i besueshmërisë së përdoruesve të synuar të Pasqyrave Financiare dhe përdorimi i fondeve publike në pajtueshmëri me autoritetet.

Auditimet financiare dhe pajtueshmërisë kryhen çdo vit. Procesi i auditimit fillon në shtator, ndërsa raportet e auditimit për OB-të individuale publikohen deri në fund të muajit qershor. Cikli i auditimeve përmbyllet në fund të muajit gusht kur Raporti Vjetor i Auditimit (RVA) për Raportin Financiar Vjetor të Buxhetit të Kosovës (RFV/BK) dorëzohet në Kuvendin e Kosovës.

5 "Pajtueshmëri me autoritetet" do të thotë përputhshmëri me aktet apo rezolutat e legjislaturës apo instrumente tjera statutorë, direktiva dhe udhëzues të nxjerra nga organet e sektorit publik me kompetenca të përcaktuara me statut, të cilave pritet t'i përmbahet entiteti i audituara. Thënë ndryshe, është pajtueshmëri me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikat e mira.

Auditimet e performancës - paraqesin një shqyrtim të pavarur, objektiv dhe të besueshëm nëse angazhimet qeveritare, sistemet, operacionet, programet, aktivitetet ose organizatat janë duke vepruar në përputhje me parimet e ekonomicitetit (minimizimi i kostove të burimeve), efikasitetit (përfitimi sa më shumë nga burimet në dispozicion) dhe efektivitetit (përmbushja e objektivave të përcaktuara dhe rezultateve të synuara). Fushat, objektivat dhe koha e auditimit dhe e raportimit përcaktohen prej rastit në rast, duke u bazuar në rëndësinë, rrezikun, fushëveprimin e auditimit, kapacitetet ekzistuese si dhe kriteret tjera përkatëse.

Auditimi i performancës fokusohet në atë se si organizatat e sektorit publik i kanë përdorur burimet në dispozicion për t'i arritur objektivat e tyre. Për ekzaminimin e performancës së entitetit të audituar, ZKA-ja ndjek një rën nga tri qasjet: qasjen e orientuar në rezultate, qasjen e orientuar në problem dhe qasjen e orientuar në sistem, ose një kombinim të të tri qasjeve.

Auditimet e teknologjisë së informacionit (TI)- pasqyrojnë vlerësimin dhe rishikimin e sistemeve të teknologjisë së informacionit dhe kontrollet e ndërlydhura me to, për të përfituar siguri ose për të identifikuar rreziqet lidhur me parimet e ligjshmërisë, efikasitetit, ekonomicitetit dhe efektivitetit të sistemeve të TI-së.

3.2. Auditimet e realizuara 2022/2023

ZKA-ja ka kryer dhe publikuar 124 raporte të auditimit gjatë vitit 2023, si në vijim:

- **107 auditime të rregullsisë (financiare dhe të pajtueshmërisë)**
 - 1 Raportin Vjetor të Auditimit për Raportin Financiar Vjetor të Buxhetit të Kosovës për vitin fiskal 2022,
 - 86 raporte për organizatat buxhetore,
 - 11 raporte të auditimit për Ndërmarrjet Publike dhe
 - 9 raporte të auditimit të projekteve (financuara nga donatorët).

- **15 auditime të performancës**
- 15 raporte të auditimit të performancës (për fusha të ndryshme si: barazi gjinore/sociale, shëndetësi, zhvillim ekonomik dhe buxhet, prokurim publik, mjedis dhe siguri, auditim paralel për ujësjellës, teknologjia e informacionit dhe auditim përcjellës).
- **2 auditime të pajtueshmërisë**
- 2 raporte me Informata të klasifikuara,, E KUFIZUAR"- (Ministria e Mbrojtjes dhe e Drejtësisë).

Në kuadër të auditimeve të performancës dhe pajtueshmërisë janë përfshirë auditime të kryera me kërkesë të Kuvendit të Kosovës dhe Qeverisë.

Tabela 1. Numri dhe llojet e auditimeve të realizuara për sezonin 2022/2023.

Llojet e auditimeve	Auditimet e realizuara
	2022/2023
Auditime të rregullsisë	107
• Buxheti i Kosovës	1
• Institucionet Qendrore	52
• Komunat	34
• Ndërmarrjet Publike	11
• Projekte	9
Auditimet e Performancës	15
• Performancë dhe Prokurim	10
• Teknologji Informative	5
Auditime të Pajtueshmërisë	2
Gjithsej	124

3.3. Auditimet e planifikuara 2023/2024

Në Planin Vjetor për sezonin e auditimit 2023/24, ZKA-ja planifikon të kryejë dhe të publikojë 123 raporte të auditimit, si në vijim:

- **107 Auditime të rregullsisë (financiare dhe të pajtueshmërisë)**

- 1 Raportin Vjetor të Auditimit për Raportin Financiar Vjetor të Buxhetit të Kosovës për vitin fiskal 2023,
- 85 organizata buxhetore (47 institucione të nivelit qendror dhe 38 të nivelit lokal)
- 13 Ndërmarrje Publike dhe
- 8 auditime të projekteve të financuara nga Banka Botërore.

- **16 Auditime të performancës**

16 auditime të performancës (për fusha të ndryshme si: Shëndetësi, Kulturë, Zhvillimi ekonomik dhe mjedisi, Prokurimi publik dhe TI).

Tabela 2. Numri dhe llojet e auditimeve të planifikuara për sezonën audituese 2023/2024.

Llojet e auditimeve	Sezoni i auditimit / plani vjetor
	2023/2024
Auditime të rregullsisë	107
• Buxheti i Kosovës	1
• Institucionet Qendrore	47 ⁶
• Komunat	38
• Ndërmarrjet Publike ⁷	13
• Projekte	8
Auditimet e Performancës	16
• Performancë dhe Prokurim	13
• Teknologji Informative	3
Auditime të Pajtushmërisë ⁸	
Gjithsej	123

Për sezonin auditues 2023/24, përveç auditimeve financiare dhe pajtushmërisë të 85 OB-ve (plus auditimi për RVA-së), do të kryhen 13 auditime të NP, si dhe 8 të projekteve të financuara nga Banka Botërore.

Përveç auditimeve të detyrueshme të rregullsisë (financiar dhe pajtushmërisë) të përcaktuar me ligj, fokus i veçantë i është dhënë ndërmarrjeve publike të cilat nuk ishin audituar një kohë të gjatë nga auditimi shtetëror siç janë: Trepça, KOSTT dhe projekte kapitale me peshë të lartë financiare.

Në krahasim me vitin e kaluar, kemi rritur kontraktimin e Institucioneve të Pavarura prej 11 në 12 të kontraktuara, po ashtu rritje ka edhe tek komunat prej 6 në 10 të kontraktuara. Këto auditime do të përkrahen nga një kompani private e auditimit,

6 (ATK, Dogana, auditohen në kuadër të MFPT-së), si dhe 2 agjenci (Agjencia për Ndhmë Juridike Falas dhe Agjencia e Komplekseve Memoriale janë fuzionuar në ministri të linjës), si dhe RTK është planifikuar të kryhet në kuadër të NP.

7 Në NP është planifiku RTK-ja

8 Gjatë vitit janë shtuar dy auditime pilot të pajtushmërisë (prokurimi dhe menaxhimi i kontratave në MSH 2023 dhe Dhënia dhe shfrytëzimi i pronave komunale dhe monitorimi i tyre në komunën e Ferizajit 2022-2023).

përderisa opinioni i auditimit përcaktohet nga Auditori i Përgjithshëm bazuar në metodologjinë e ZKA-së dhe në përputhje me SNISA-t. Rritja e auditimeve të kontraktuara ka ndodh për shkak të largimit (dorëheqjeve) të stafit profesionist nga puna, kryesisht për shkak të pagave jo të konkurrueshme për këtë profesion. Arsye tjetër ka qenë fokusimi i angazhimit të kapaciteteve njerëzore në dispozicion në fushat me rrezik të lartë.

Vlen të theksohet se ZKA ka krijuar mekanizma të brendshëm në trajtimin e kërkesave të ndryshme që vijnë nga palët e jashtme për auditime me kërkesë, dhe si të tilla janë trajtuar në mënyrën efektive.

3.4. Rezultatet e auditimit dhe adresimi i rekomandimeve të auditimit financiar dhe të pajtueshmërisë

Raporti Vjetor i Auditimit (RVA) për Pasqyrat Financiare Vjetore të Buxhetit të Republikës së Kosovës të vitit 2022 është dorëzuar në Kuvendin e Kosovës brenda afatit ligjor në gusht të vitit 2023. Auditori i Përgjithshëm ka prezantuar RVA-në në seancë plenare të Kuvendit të Kosovës.

- **Përmbledhje të mangësive të identifikuara në raportet e auditimit 2023**
 - **Organizatave buxhetore** - Cilësia e raportimit financiar ende vazhdon të mos jetë në nivelin e pritur për shkak se nga 86 auditimet e Pasqyrave Vjetore Financiare të organizatave buxhetore 33 kishin keqdeklarime materiale të cilat kanë rezultuar me opinion të modifikuar/kualifikuar, ndërsa 53 të tjera kanë rezultuar me opinion të pamodifikuar. Megjithatë, krahasuar me vitin e kaluar cilësia e raportimit financiar është përmirësuar për shkak se në vitin 2022 janë 13 organizata buxhetore më pak të cilat kanë marrë opinion të modifikuar. OB-të me numër më të lartë të opinionëve të modifikuar vazhdojnë të jenë ato të nivelit lokal. Prezantimi i saktë dhe i plotë i informatave financiare e rrit besueshmërinë e lexuesve ndaj raportimit financiar.

Përveç këtyre, ZKA ka evidentuar çështje që lidhen me kontrollat dhe menaxhimin financiar si: planifikim dhe realizim të buxhetit, rritje e

llogarive të arkëtueshme, detyrimet e papaguara dhe kontigjente, pagesat sipas vendimeve gjyqësore dhe përmbartimore, si dhe pasuritë jo financiare.

- **Ndërmarrjet Publike** - Cilësia e raportimit financiar edhe pse krahasuar me vitin e kaluar është përmirësuar në masë të konsiderueshme, megjithatë ende vazhdon të mos jetë në nivelin e pritur. Nga 11 auditimet e pasqyrave financiare të ndërmarrjeve publike, tek 1 është dhënë opinion i pamodifikuar, ndërsa tek 10 të tjera opinion i modifikuar (7 opinion të kualifikuar dhe 3 të kundërta).
- **Auditimet e Performancës, Teknologjisë së Informacionit dhe Prokurimit** - Auditimet e kryera gjatë vitit 2022, kanë identifikuar mangësi në fusha me rëndësi ekonomike, shëndetësore, të mirëqenies sociale dhe prokurimit publik, që tregojnë për mungesën e efikasitetit, llogaridhënies, efektivitetit dhe mos arritjen e vlerës për parane e shpenzuar dhe shërbimeve ndaj qytetarëve.
- **Zbatimi i rekomandimeve** - Nga raportet individuale të auditimit është vlerësuar se 49% e rekomandimeve të dhëna në vitin 2021 janë zbatuar plotësisht.

Tabela 3 - Numri i rekomandimeve të dhëna në raportet individuale të OB-ve në tre vite

Subjektet e audituara	2022	2021	2020
Niveli qendror	165	185	244
Niveli lokal	352	409	367
Institucionet e pavarur	54	55	43
Gjithsej	571	649	654

Të dhënat e paraqitura në tabelë tregojnë për ulje të numrit të rekomandimeve krahasuar me vitin paraprak tek komunat dhe institucionet qendrore. Konkluzioni i përgjithshëm është se ndikimi i punës së ZKA-së mund të vërehet në fushat si në vijim: zvogëlimi i transaksioneve financiare të parregullta, përmirësimi i gabimeve si rezultat i auditimit dhe rritja e transparencës për shpenzimin e parasë publike (të gjitha raportet e auditimit janë publikuar dhe raportet e performancës janë prezantuar para publikut dhe palëve të interesit).

Tabela 4. Progresi i zbatimit të rekomandimeve në vitin 2022 nga viti 2021 në OB

Auditimet sipas fushave	Rek.	Rek. nuk janë aplikueshme ⁹	Rek. për zbatim	Të zbatuara %		Të adresuara pjesërisht apo në proces %		Të pa zbatuara %	
Institucionet e nivelit qendrorë	185	5	180	88	49%	20	11%	72	40%
Institucionet e pavarura	55	1	54	39	72%	3	6%	12	22%
Institucionet e nivelit lokal	409	3	406	186	46%	33	8%	187	46%
Gjithsej	649	9	640	313	49%	56	9%	271	42%

ZKA, në raportet e auditimit të vitit 2021 kishte dhënë 649 rekomandime dhe gjatë auditimit në vitin 2022 kishte vlerësuar zbatimin e rekomandimeve. Sipas këtij vlerësimi, 49% e rekomandimeve ishin zbatuar plotësisht, 9% ishin zbatuar pjesërisht, 42% nuk janë zbatuar.

ZKA, ka audituar 11 Ndërmarrje Publike për vitin fiskal 2022. Rezultati përcjellës dhe analizimi i progresit në zbatimin e rekomandimeve për këto NP është paraqitur më poshtë.

Tabela 5 - Numri i rekomandimeve të dhëna në NP për vitin 2022

Subjektet e audituara	Totali i rek.	Rek. e reja	Rek. e përsëritura	Rek. e pazbatuara
Ndërmarrjet Publike	134	59	70	5

Në vitin 2022 janë dhënë 134 rekomandime, prej tyre 59 janë të reja, 70 të përsëritura dhe 5 nuk janë zbatuar.

9 Këto rekomandime janë rezultat i fuzionimit të ministrive.

Tabela 6. Progresi i zbatimit të rekomandimeve në vitin 2022 nga viti 2021 në NP

Auditimet sipas fushave	Rek.	Rek. nuk janë aplikueshme	Rek. për zbatim	Të zbatuara %		Të adresuara pjesërisht apo në proces %		Të pa zbatuara %	
Ndërmarrjet Publike	187	8	179	104	58%	70	39%	5	3%
Gjithsej	187	8	179	104	58%	70	39%	5	3%

Në raportet e auditimit të vitit 2021, janë dhënë 187 rekomandime dhe gjatë auditimit në vitin 2022 është vlerësuar zbatimi i rekomandimeve. Sipas këtij vlerësimi, 58% e rekomandimeve ishin zbatuar plotësisht, 39% janë në proces të zbatimit dhe 3% nuk janë zbatuar.

3.5. Auditimet e performancës

Zyra Kombëtare e Auditimit gjatë vitit 2023 ka kryer 15¹⁰ auditime të performancës, prokurimit dhe teknologjisë së informacionit. Këto auditime kanë mbuluar fusha me interes për qytetarët, Kuvendin e Kosovës dhe palët e tjera të interesit, me fokus në: barazi gjinore/sociale, shëndetësi, mjedis dhe siguri, zhvillim ekonomik dhe buxhet, prokurim publik si dhe teknologji të informacionit. Po ashtu në fushën e teknologjisë së informacionit, kemi kryer një auditim paralel me Kontrollin e Lartë të Shtetit të Shqipërisë për Ujësjellësit e Tiranës dhe Prishtinës.

10 Këtu përfshihet edhe raporti përmbledhës në auditimin paralel Sistemet e Informacionit në Kompaninë Rajonale të Ujësjellësit-Prishtina

Tabela 7. Numri dhe fushat e auditimeve të performancës, prokurimit dhe TI-së

Numri auditimeve nëpër fusha	Fusha	Tema
1	Barazi gjinore/ sociale	Efektiviteti i institucioneve në trajtimin e rasteve të dhunës në familje
1	Mjedis dhe siguri/zhvillim ekonomik	Ndikimi i investimeve kapitale në zvogëlimin e humbjeve të ujit dhe zgjerimin e shërbimeve tek qytetarët nga KRU-të
1	Zhvillim ekonomik dhe buxhet	Të hyrat nga qiraja në Agjencinë Kosovare të Privatizimit për periudhën 2012-2021
1	Zhvillim ekonomik dhe buxhet	Mbështetja e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme nga MINT/KIESA
1	Shëndetësi	Efektiviteti i Programit për Trajtimin e Pacientëve Jashtë Institucioneve Shëndetësore publike
4	Prokurim	<p>Prokurimet e negociuara pa publikim të njoftimit për kontratë në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës në vitin 2021</p> <p>Renovimi dhe rikonfigurimi i Stadiumit të qytetit në Mitrovicë, Gjilan dhe Gjakovë</p> <p>Ekonomiciteti dhe efikasiteti në ndërtimin e shtëpive për të kthyerit</p> <p>Funksionimi i sistemit të Grantit të Performancës Komunale dhe menaxhimi i projekteve të financuara nga Donatorët për vitin 2021</p>
1	Auditim përcjellës/ Follow up	Vlerësimi i zbatimit të rekomandimeve të raporteve të auditimit të performancës të vitit 2018

3	Teknologji e informacionit	<p>Menaxhimi i Projekteve për Sistemet e Teknologjisë së Informacionit në Agjencinë e Shoqërisë së Informacionit</p> <p>Sistemi elektronik i prokurimit publik e-prokurimi</p> <p>Menaxhimi i sistemeve të informacionit në Institutin Bujqësor të Kosovës</p>
2	Auditimi paralel ZKA - KLSH	<p>Sistemet e Informacionit në Kompaninë Rajonale të Ujësullësit-Prishtina</p> <p>Raporti i Përbashkët në Auditimin Paralel Sistemet e Informacionit në Ujësullësit e Tiranës dhe Prishtinës</p>

Në këto auditime ZKA-ja ka përfshirë 41 organizata, prej tyre 8 Ministri, 14 Komuna, 5 Ndërmarrje Publike dhe 14 tjera (Rregullatorë, Agjenci, Gjykata, Prokurori, Qendra për Punë Sociale, Mbrojtës të Viktimave dhe Policia Rajonale e Kosovës). Përveç këtyre organizatave auditimi përcjellës është shtrirë në 46 organizata tjera buxhetore. Për organizatat e audituara janë dhënë 173 rekomandime, ku tri prej këtyre rekomandimeve janë dhënë për Qeverinë e Kosovës me qëllim të adresimit më të shpejt/urgjent të disa çështjeve.

Tabela 8. Auditimet, entitetet, mesazhi i auditimit dhe numri i rekomandimeve të dhëna

Auditimi/tema	Entitetet ne auditim	Mesazhi i auditimit	Nr. i rek.
Efektiviteti i institucioneve në trajtimin e rasteve të dhunës në familje	Policia e Kosovës (dy komuna) Mbrojtësit e Viktimave (dy komuna) Qendra për Punë Sociale (dy komuna) Prokuroria Themelore (dy komuna) Gjykata Themelore (dy komuna)	Sistemi shtetëror ka defekte në përfshirje të mbrojtësve të viktimave si dhe shqyrtim të rasteve me kohë nga organet e drejtësisë, në regjistrimin e rasteve të raportuara. Viktimat nuk kanë përkrahje sociale, në veçanti mungon përkrahja e tyre në aspektin ekonomik.	19
Ndikimi i investimeve kapitale në zvogëlimin e humbjeve të ujit dhe zgjerimin e shërbimeve tek qytetarët nga KRU-të	Ministri (një) Autoriteti Rregullator i Ujit ARrU dhe Kompania Rajonale e Ujësjellësit (katër)	Procesi i planifikimit, realizimit dhe monitorimit të Investimeve Kapitale, nga Kompanitë Rajonale të Ujësjellësit dhe Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit nuk është menaxhuar mirë duke ndikuar që objektivat e synuara të mos arrihen me kohë dhe në mënyrën e duhur. Madje, disa nga këto objektiva devijojnë nga ajo çfarë është planifikuar. Mungesa e planifikimit të bazuar në nevojë dhe arsyetim të detajuar, tregon dobësi në priorizimin e investimeve, ku për pasojë ka vonesa të theksuara dhe shfrytëzim joefektiv të tarifave të qytetarëve.	16
Të hyrat nga qiraja në Agjencinë Kosovare të Privatizimit për periudhën 2012-2021	Agjencion	Agjencia Kosovare e Privatizimit nuk kishte bërë përpjekje të mjaftueshme për të menaxhuar si duhet pronat dhe asetet shoqërore. Mungesa e veprimeve lidhur me menaxhimin e pronave të dhëna me qira nga Agjencia, tregon që sistemi i kontrollit të brendshëm nuk ishte në nivelin e duhur. Si rezultat i kësaj, Agjencia nuk kishte arritur të siguroj rritjen e të hyrave nga prona e dhënë me qira.	9

Mbështetja e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme nga MINT/KIESA	MINT/KIESA nuk ka arritur rezultatet e duhura në përkrahjen dhe ngritjen e kapaciteteve të NMVM-ve dhe Zonave Ekonomike. Thirrjet publike nuk mbështeten në analiza për nevojat e NMVM-ve, po ashtu sistemi i thirrjeve, vlerësimi dhe monitorimi përcillet me mangësi të theksuara të cilat kanë nevojë për përmirësim.	8
Prokurimet e negociuara pa publikim të njoftimit për kontratë në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës në vitin 2021	Ministria për Komunitete dhe Kthim nuk ishte ekonomike në kontraktimin e ndërtimit të shtëpive. Mangësitë ishin evidente nga faza e vlerësimit dhe arsyeshmërisë së nevojave dhe hulumtimi i çmimeve të tregut. Ministria kishte filluar procedurat e prokurimit pa pasur informacionet e duhura për përfituesit dhe statusin e tyre të banimit. Praktika e tillë ishte përsëritur edhe në kontratën e dytë pavarësisht problemeve të hasura në kontratën e parë. Ministria ka kontraktuar ndërtimin e shtëpive për 832,033 euro më shtrenjtë se sa çmimet e tregut, kjo vetëm duke krahasuar së paku me çmimet e Administratës Tatimore të Kosovës.	11

Ministri dhe Agjencion

Ministri

<p>Renovimi dhe rikonfigurimi i Stadiumit të qytetit në Mitrovicë, Gjilan dhe Gjakovë</p>	<p>Ministria e Kulturës, Riniisë dhe Sporteve së bashku me Komunitat Mitrovicë, Gjilan dhe Gjakovë nuk ishin treguar efikase në menaxhimin e renovimit dhe rikonfigurimit të stadiumeve. Kjo kishte ndodhur për arsye se nuk ishin siguruar parakushtet e nevojshme me kohë. Gjatë renovimit dhe rikonfigurimit të këtyre stadiumeve nuk janë arritur qëllimet e përcaktuara, pasi që kanë kaluar disa vite (nga katër e deri në shtatë) që nga fillimi i procesit dhe ato përveç që ende nuk kanë përfunduar dhe sipas gjendjes në terren janë larg përfundimit dhe funksionalizimit të tyre. Mos përfundimi i tyre dhe për shkak të ngarkesës të stadiumit të vetëm i cili i përmbush kriteret e UEFA-së, rrezikon që Kombëtarja e Kosovës dhe klubet sportive të detyrohen që ndeshjet me karakter ndërkombëtar t'i zhvillojnë në një shtet të rajonit. Mangësitë kryesore kishin të bëjnë me krijimin e parakushteve siç janë probleme me projektet ideore dhe kryesore, mos shpronësimi me kohë, mos pajisja me leje të ndërtimit dhe mos kategorizimi i duhur.</p>	<p>9</p>
<p>Efektiviteti i Programit për Trajtimin e Pacientëve Jashtë Institucioneve Shëndetësore</p>	<p>Fondi për Sigurime Shëndetësore së bashku me Bordin Ekzekutiv nuk ishin efektiv në procesin e menaxhimit të subvencionimit të pacientëve për trajtim jashtë institucioneve shëndetësore publike. Pacientët nuk ishin trajtuar në mënyrë të barabartë, qoftë në aplikim apo edhe në aprovim të kërkesave. Kishte praktika të ndryshme në vlerësimin dhe trajtimin e lëndëve duke filluar nga aplikimi i kriterëve të ndryshme për rastet e njëjta e deri te shumta e aprovuar për trajtim. Kishte vonesa në aprovim të lëndëve dhe po ashtu kishte vonesa në pagesë të tyre. Obligimet financiare nuk ishin menaxhuar dhe raportuar në mënyrë të duhur dhe për më tepër Fondi nuk kishte arritur që të bëjë të gjitha barazimet financiare me institucionet shëndetësore në të cilat janë parapaguar shërbimet. Si rezultat i këtyre çështjeve, Fondi së bashku me Bordin Ekzekutiv nuk kishin trajtuar të gjithë pacientët në mënyrë të barabartë.</p>	<p>13</p>

Ministri dhe Komuna

Organizatë Buxhetore (Institucion Publik Shëndetësor)

<p>Vlerësimi i zbatimit të rekomandimeve të raporteve të auditimit të performancës të vitit 2018</p>	<p>Zbatimi i disa rekomandimeve në nivel individual të subjekteve të audituara në tre nga shtatë raportet e auditimit të performancës ka ndikuar në përmirësimin e gjendjes së identifikuar. Megjithatë, duke e pasur parasysh që rekomandimet për këto raporte janë dhënë në vitin 2018, pra kanë kaluar rreth pesë vite nga gjendja e konstatuar aso kohe, angazhimet e subjekteve të audituara për të zbatuar rekomandimet e dhëna nuk janë të mjaftueshme. Auditimi përcjellës ka shpalosur se niveli i zbatimit të plotë të rekomandimeve për shtatë raportet e auditimit të performancës ishte 37%, ndërsa 25% e rekomandimeve janë trajtuar dhe janë në faza të ndryshme të zbatimit të tyre ndërsa pjesa tjetër ose nuk janë zbatuar, nuk janë më të aplikueshme ose edhe nuk kemi mundur t'i vlerësojmë sepse subjektet e audituara nuk kanë kthyer përgjigje. Nga 123 rekomandime të dhëna, 45 prej tyre janë zbatuar, shtatë janë në fazën finale të zbatimit, dhjetë rekomandime janë duke u zbatuar, pesë rekomandime nuk kanë filluar të zbatohen, 14 rekomandime nuk janë më të aplikueshme për subjektet e adresuara (për 9 nga to përgjegjësitë kanë kaluar në subjekte tjera derisa pesë nuk janë të aplikueshme më), ndërsa për 42 rekomandime nuk kemi marrë përgjigje fare nga subjektet e audituara për të kuptuar nëse është marrë ndonjë veprim apo jo për zbatimin e atyre rekomandimeve.</p>	2
<p>Ekonomiciteti dhe efikasiteti në ndërtimin e shtëpive për të kthyerit</p>	<p>Ministria për Komunitete dhe Kthim nuk ishte ekonomike në kontraktimin e ndërtimit të shtëpive. Mangësitë ishin evidente nga faza e vlerësimit dhe arsyeshmërisë së nevojave dhe hulumtimi i çmimeve të tregut. Ministria kishte filluar procedurat e prokurimit pa pasur informacionet e duhura për përfituesit dhe statusin e tyre të banimit. Praktika e tillë ishte përsëritur edhe në kontratën e dytë pavarësisht problemeve të hasura në kontratën e parë. Ministria ka kontraktuar ndërtimin e shtëpive për 832,033 euro më shtrenjtë se sa çmimet e tregut, kjo vetëm duke krahasuar së paku me çmimet e Administratës Tatimore të Kosovës.</p>	2

Funksionimi i Grantit të Performancës Komunale i ndarë në dy qasje (dy burime të financimit) ka rezultuar me mangësi të cilat duhet të ju kushtohet vëmendje. Mangësitë kryesore të identifikuar janë: mjetet e ndara nga MAPL kërkojnë miratim shtesë, regjistrimi i dyfishtë i projektit si investim në vijim, kthimi i mjeteve si suficit dhe mungesa e kriterëve për caktimin se cila komunë nga cili burim do të përfitoj.

Aktivitetet e prokurimit (zhvillohen nga komunat përfituese të grantit) për projektet e financuara nga Donatorët gjatë vitit 2021 ishin përcjellë me dobësi të ndryshme duke filluar nga mos përfshirja e projekteve në plan të prokurimit, ndarja e tenderëve në LOT-e e cila ka rezultuar me çmime më të larta, mos konfiskim i sigurisë së tenderit, nënshkrimi i kontratave pa caktuar vend punimin paraprakisht dhe dobësi të ndryshme në menaxhimin e kontratave. Më tutje, edhe pse rezultatet e synuara për projektet e realizuara janë arritur, komunat nuk kanë dëshmuar mjaftueshëm se kanë integruar grupet e marginalizuara në këto nisma, përveç në politika lehtësuese e strategji të komunave.

9

Ministri dhe 11 Komuna

Funksionimi i sistemit të Grantit të Performancës Komunale dhe menaxhimi i projekteve të financuara nga Donatorët për vitin 2021

Kompania Rajonale e Ujësjellësit Prishtina nuk ka siguruar një mjedis efektiv të kontrollit për të ruajtur integritetin dhe vazhdimësinë e sistemeve të TI-së, duke ndikuar negativisht në arritjen e plotë të qëllimeve të ndërmarrjes dhe duke zbehur besueshmërinë e sistemeve të ndërmarrjes.

18

Ndërmarrja Publike-Kompani Rajonale e Ujësjellësit

Sistemet e Informacionit në Kompaninë Rajonale e Ujësjellësit Prishtina

<p>Menaxhimi i Projekteve për Sistemet e Teknologjisë së Informacionit në Agjencinë e Shoqërisë së Informacionit</p>	<p>Procesi i zhvillimit të projekteve të teknologjisë së informacionit nuk është menaxhuar mirë nga Agjencia e Shoqërisë së Informacionit. Kjo ka ndikuar në mosrealizimin e shërbimeve, në moshtrajtimin e duhur të sigurisë së informacionit, duke ndikuar edhe në shpenzime të pa nevojshme dhe dëmtim të buxhetit. Mangësitë e zbatimit të projekteve që janë të ndërlidhura në mes veti si dhe ndërmjet institucioneve kanë ndikuar në rritjen e shpenzimeve për këtë fushë në nivel vendi</p>	<p>18</p>
<p>Sistemi elektronik i prokurimit publik e-prokurimi</p>	<p>Sistemi elektronik "E-Prokurimi" ka ndihmuar në rritjen e efikasitetit, efektivitetit dhe transparencën e zhvillimit të aktiviteteve të prokurimit publik. Megjithatë, janë vërejtur mangësi në operacionet e teknologjisë së informacionet të cilat ndikojnë në ruajtjen e vazhdueshme të qëndrueshmërisë dhe integritetit të këtij sistemi. Mangësitë janë në Qeverisjen dhe operacionet e e-prokurimit si dhe Kontrolllet hyrëse dhe siguria e sistemit.</p>	<p>13</p>
<p>Menaxhimi i sistemeve të informacionit në Institutin Bujqësor të Kosovës</p>	<p>Ministria dhe Instituti nuk kanë menaxhuar si duhet projektet e teknologjisë e informacionit në vlerë të përgjithshme 700,766 euro, duke dështuar në përfshirjen e profesionistëve të TI-së në planifikimin, zhvillimin dhe pranimin e projekteve. Rrjedhimisht, janë zhvilluar dy sisteme të ndara në vlerë 567,406 euro për të njëjtin qëllim, për më tepër ato nuk po përdoren. Mungesa e sigurimit të cilësisë, mangësitë në konfigurimin e sistemit dhe mangësitë në sigurinë dhe vazhdimësinë e sistemit të informacionit kanë rezultuar në disa shpenzime të panevojshme dhe dëmtime buxhetore.</p>	<p>15</p>

Raporti i
Përbashkët
në Auditimin
Paralel Sistemet
e Informacionit
në Ujësllësit
e Tiranës dhe
Prishtinës

Ndërmarrja Publike-
Kompani Rajonale e
Ujësllësit

Konkluzioni i përgjithshëm nga auditimi paralel nxjerr në pah mangësi të theksuara në qeverisjen e TI-së, sigurinë e informacionit dhe vazhdimësinë e shërbimeve. KRU Prishtina nuk ka siguruar një mjedis efektiv të kontrollit për të ruajtur integritetin dhe vazhdimësinë e sistemeve të TI-së, duke ndikuar negativisht në arritjen e plotë të qëllimeve të ndërmarrjes dhe duke zbehur besueshmërinë e sistemeve të ndërmarrjes. Në shoqërinë Ujësllëse Kanalizime Tiranë Sh.A mungojnë strategjia, politikat dhe aktet rregullativë që përcaktojnë drejtimin, përgjegjësitë dhe detyrimet mbi përdorimin e Teknologjisë së Informacionit.

011

11 Në Raportet individuale janë dhënë 18 rekomandime për Kompaninë Rajonale të Ujësllësit Prishtina dhe 15 rekomandime për Ujësllësin e Tiranës.

Aktivitetet kryesore të zhvilluara në funksion të mandatit të ZKA-së:

Krahas auditimeve, me qëllim të ngritjes së kapaciteteve, thellimit të bashkëpunimit dhe ngritjes profesionale gjatë vitit 2023, Zyra Kombëtare e Auditimit ka zhvilluar një sërë aktivitetesh në nivel vendor dhe ndërkombëtar.

Zyra Kombëtare e Auditimit bëhet pjesë aktive në takimet e Grupit Punues për TI në EUROSAI - ZKA-ja u përfaqësua në takimin vjetor të Anëtareve të nëngrupit për e-Qeverisje nga Grupi punues për TI në EUROSAI (ITWG), në Lisbonë në prill 2023. Takimi u organizua nga ISA¹² i Portugalisë (Tribunal de Contas of Portugal) dhe ISA i Polonisë (NIK). Në këtë takim ndër të tjera u diskutua struktura e raporteve të TI-së, me ç' rast si shembull u prezantua Raporti i Auditimit të TI-së i Zyrës Kombëtare të Auditimit, duke vlerësuar mjaft mirë strukturën e raportit dhe punën e ZKA-së. Ndërsa ZKA u përfaqësua edhe në punimet/trajnimet për përdorimin efikas të funksionaliteteve të Manualit Aktiv për Auditimet e TI-së. Aktivitetet në kuadër të këtij bashkëpunimi vazhduan edhe në qershor 2023 në Varshavë/Poloni.

Zyra Kombëtare e Auditimit bëhet pjesë e programit të IDI-LOTA Pioneers - Zyra Kombëtare e Auditimit, ka nominuar/dërguar dy zyrtarë të saj në programin dyvjeçar "Pionierët duke Përdorur Avancimin e Teknologjisë (LOTA Pioneers)" të Inicativës për Zhvillim e INTOSAI-t/IDI. Rritja e interesimit për dixhitalizimin e auditimit ka bërë që ky program këtë vit të ndiqet nga rreth 70 përfaqësues të Institucioneve Supreme të Auditimit nga vende të ndryshme. LOTA Pioneers ka për qëllim t'iu sigurojë ISA-ve agjentë kompetentë të ndryshimit të cilët do të ndihmojnë në zhvillimin e një strategjie afatgjatë të auditimit për teknologjinë e informacionit dhe kryerjen e një auditimi të teknologjisë së informacionit në ISA-të përkatëse.

Auditorja e Përgjithshme e përfaqësoj Institucionin e Auditorit të Kosovës në takimin e liderëve të Institucioneve Supreme të Auditimit në Itali - Auditorja e Përgjithshme e Kosovës, znj. Vlora Spanca, mori pjesë në takimin e parë të grupit punues mbi përfitimet dhe metodologjitë e "auditimit në kohë reale", i cili operon nën qëllimin e parë strategjik të EUROSAI-t.

12 ISA-Institicioni Suprem i Auditimit, SAI-Supreme Audit Institution

Kjo ngjarje ishte mundësi e shkëmbimit të përvojave dhe ideve të reja të nikoqirëve dhe liderëve/përfaqësuesit nga Institucionet Supreme të Auditimit nga vende të ndryshme në lidhje me përfitimet dhe metodologjitë e auditimit në kohë reale.

Në kuadër të vizitës në Itali, Auditorja e Përgjithshme, është pritur në takim të veçantë nga Presidenti i Gjykatës së Auditorëve të Italisë, Guido Carlino, i cili ka shprehur gatishmërinë e institucionit të tij për bashkëpunim ndërinstitucional përmes zhvillimit të aktiviteteve bilaterale dhe atyre në kuadër të rrjeteve të EUROSAI-t dhe INTOSAI-t.

Po ashtu Auditorja e Përgjithshme e Republikës së Kosovës, gjatë kësaj vizite është takuar edhe me ambasadorin e Kosovës në Itali, të cilën e ka njoftuar për punën audituese, sfidat dhe rezultatet e auditimit.

Zyra Kombëtare e Auditimit është përfaqësuar edhe në ngjarje të tjera të nivelit ndërkombëtar, si: në webinar në nivel ndërkombëtar të organizuar nga Iniciativa për Zhvillim (IDI) e Organizatës Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (INTOSAI) në Qershor 2023, ZKA prezantoi përvojën dhe zhvillimin institucional në fushën e teknologjisë së informacionit në kuadër të temës “Inovacionet në Institucionet Supreme të Auditimit”-Auditimi i Teknologjisë së Informacionit. Në theks të veçantë përfaqësuesit tanë ofruan përvojën e tyre në lidhje me “Sistemin e Menaxhimit të Auditimit – SITA në Zyrën Kombëtare të Auditimit të Kosovës”. Panelistët nga Zyra Kombëtare e Auditimit prezantuan zhvillimin institucional të ZKA-së, me theks në auditimet e TI-së. Më tej u prezantua organizimi dhe puna në Departamentin për Auditimet e TI dhe Raporti i Auditimit të TI-së Sistemi Informativ i Gjendjes Civile në Agjencinë e Regjistrimit Civil. Po ashtu para pjesëmarrësve u bë prezantimi i Sistemit Informativ për Menaxhimin e Auditimeve në ZKA, SITA.

Përfaqësime të tjera të niveleve bilaterale, të ndjekjes së përvojave të reja dhe kontributit të ZKA-së gjatë vitit 2023 janë zhvilluar edhe përmes takimeve, vizitave nga dhe tek institucionet relevante të shteteve të ndryshme, si: Shqipëria, Maqedonia e Veriut, Mali i zi, Portugalia, Suedia, etj.

Bashkëpunimi me UN Women – Organizata UN Women përmes degëve të sajë në rajon dhe Kosovë po zbaton një sërë aktiviteteve për të mbështetur ISA-t në Kosovë, Shqipëri dhe Maqedoninë e Veriut, që të integrojnë perspektivën gjinore në auditim. Këtë vit UN Women ka përkrahur ZKA-në në auditimin “Efektiviteti i institucioneve në trajtimin e rasteve të dhunës në familje” duke e mbështetur

me trajnime dhe vizita studimore. Bashkëpunimi ende vazhdon me UN Women në auditimin e ardhshëm që po ashtu ka të bëjë me barazi gjinore, auditim ky paralel edhe me ISA-t e tjerë.

Auditimi paralel në fushën e teknologjisë së informacionit ndërmjet ZKA dhe KLSH

- Zyra Kombëtare e Auditimit të Kosovës dhe Kontrolli i Lartë i Shtetit të Shqipërisë në vitin 2023 kanë përfunduar projektin e përbashkët në fushën e auditimeve të teknologjisë së informacionit. Auditimi është zhvilluar për Ujësullësit në Tiranë (nga KLSH) dhe Prishtinë (nga ZKA). Nga ky projekt i përbashkët janë realizuar dy raporte individuale nga ZKA dhe KLSH si dhe në dhjetor 2023 është finalizuar raporti përmbledhës i përbashkët. Me këtë rast krerët e dy institucioneve të auditimit, ZKA-KLSH, në lansimin e rezultateve të auditimit vlerësuan lartë projektin e bashkëpunimit dhe u zotuan në thellimin e mëtejshëm të bashkëpunimit në fushën e auditimeve.

ZKA-ja ka kontribuar në promovimin e luftës kundër korrupsionit nga ana e institucioneve publike”

- Në kuadër të javës kundër korrupsionit, ZKA me mbështetjen e USAID-it ka mbajtur tryezën e punës “Roli i institucioneve publike në luftën kundër korrupsionit,” ku morën pjesë drejtues dhe përfaqësues nga Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit, Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, Inspektorati Policor i Kosovës, Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, GIZ-i si dhe OShC.

Krerët dhe përfaqësues të Institucioneve kishin mundësi të ofrojnë kontributin e tyre në lidhje me masat dhe veprimet që duhen ndërmarr për të luftuar dukurinë e korrupsionit në Kosovë.

Auditorja e Përgjithshme e Republikës së Kosovës, vlerësoi se ky aktivitet përveç rritjes së ndërgjegjësimit për efektet e korrupsionit në menaxhimin e parasë publike ka për qëllim edhe avancimin e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve publike që direkt apo indirekt kontribuojnë në luftën kundër korrupsionit. Në këtë kontekst, ajo theksoi se është i domosdoshëm angazhimi i përbashkët i institucioneve që kanë mandat për parandalimin dhe luftimin e korrupsionit.

Bashkëpunimi me organizatat e shoqërisë civile, profesionale, donatorët dhe qytetarët - ZKA-ja në aspektin strategjik synon rritjen e bashkëpunimit me organizatat e shoqërisë civile (OShC), profesionale dhe donatorët gjatë gjithë procesit të auditimit.

Lidhur me këtë, gjatë vitit 2023 ZKA ka organizuar aktivitete të përbashkëta në kuadër të bashkëpunimit dhe partneritetit me OShC-të, shoqatat profesionale dhe donatorët, në veçanti për fushën e auditimeve të performancës.

Qëllimi i këtyre aktiviteteve ishte “Fuqizimi i bashkëpunimit mes ZKA-së dhe shoqërisë civile për të rritur ndikimin e auditimit në institucionet publike”. Në takimin e parë në korrik 2023 me OShC-të, shoqatat profesionale dhe donatorët, janë trajtuar tema të mundshme për auditim që janë me interes të veçantë për t’u audituar nga Zyra Kombëtare e Auditimit në sezonin auditues 2023–2024.

Pjesëmarrësit e kanë konsideruar si shumë të rëndësishme këtë mundësinë e dhënë dhe bashkëpunimin e ofruar duke shprehur gatishmërinë për të dhënë kontributin e tyre në këtë proces, duke konfirmuar propozimet e temave nga ZKA-ja, por edhe duke propozuar tema të rëndësishme për t’u konsideruar nga Auditorja e Përgjithshme për planin e auditimit për sezonin 2023-2024.

Zyra Kombëtare e Auditimit tashmë ka kryer auditimin e njëres nga dy temat e propozuara nga OShC-të (Sponsorizimi i sportit, ndërsa auditimi i kontratave të institucioneve publike me Caritas Kosova është në proces. Mundësi për të ofruar propozime në përcaktimin e temave të auditimit u është dhënë edhe qytetarëve të ndryshëm të cilat nga ZKA janë konsideruar në varësi të rëndësisë, rrezikut apo materialitetit të çështjeve.

Auditorë të performancës pjesë aktive në skemën e trajnimeve regjionale të organizuara nga Zyra Kombëtare e Auditimit të Suedisë - Pesë auditorë të performancës në fushën e prokurimit, nga janari i vitit 2023 janë pjesë aktive e skemës së trajnimeve për auditim të performancës. Ky Program është i ndarë në gjashtë module dhe është kombinimin midis trajnimeve me prezencë fizike, atyre online dhe monitorimit të auditimit në vazhdimësi. Pjesëmarrës në këtë program janë auditorë nga ISA-t e; Kosovës, Shqipërisë, Malit të Zi, Maqedonisë së Veriut dhe Turqisë.

Fokusi i trajnimit është zhvillimi i punës praktike, shkëmbimi i eksperiencave me auditorët e shteteve pjesëmarrëse dhe aplikimi i teknikave më të mira të bazuara në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit më qëllim që t’i bëjë rezultatet e auditimit dhe mesazhin kryesor sa më të kuptueshëm dhe të qartë për publikun. Programi përfshinë aspektet e metodologjisë së auditimit, nga planifikimi deri te

raportimi i rezultateve. Pas përfundimit të të gjitha moduleve pjesëmarrësit do të certifikohen për këtë Program nga Zyra Kombëtare e Auditimit të Suedisë, e që pritet të përfundoj në maj të vitit 2024.

ZKA ka marrë pjesë në tryezën “Bashkëpunimi me shoqërinë civile për të përmirësuar kuptimin dhe ndikimin e Institucioneve Supreme të Auditimit”, në Bosnje dhe Hercegovinë – Ngjarja është organizuar nga Zyra e Auditimit të Bosnjës dhe Hercegovinës me mbështetjen e SIGMA-s në kuadër të Rrjetit të vendeve kandidatë dhe kandidatë të mundshme për anëtarësim në Bashkimin Evropian dhe në Gjykatën Evropiane të Auditorëve. Zyra Kombëtare e Auditimit të Kosovës u përfaqësua nga dy zyrtarë të saj. Në këtë tryezë zyrtarët e ZKA-së, përveç që kishin mundësi të përfitojnë përvojat e vendeve pjesëmarrëse ofruan edhe kontributin e tyre nga përvojat e Zyrës Kombëtare të Auditimit të Kosovës.

Auditorët nga ZKA certifikohen në programin e IDI “Edukimi Profesional për Auditorë (PESA-P)” – Dy auditorë të ZKA-së me sukses të plotë përfunduan programin për Edukim Profesional për Institucionet Supreme të Auditimit (PESA-P), i mundësuar nga Iniciativa për Zhvillim e INTOSAI-t dhe u certifikuan si “Auditorë të Certifikuar nga IDI”. Ky certifikim është i rëndësishëm sepse veçantë për Zyrën sepse avancojnë nivelin e profesionalizmit dhe cilësinë e punës së ZKA-së. Këtë program janë duke e vazhduar edhe auditorë tjerë nga ZKA të cilët pritet të certifikohen së shpejti.

3.6. Kontrolli i cilësisë

Menaxhimi i cilësisë në procesin e auditimit realizohet në përputhje të plotë me vizionin, misionin dhe mandatin e ZKA-së, si institucion i besueshëm dhe përmes kryerjes së auditimeve cilësore.

Qëllimi i auditimit është që t'i ofrojë siguri palëve të interesit dhe publikut të gjerë për cilësinë e raporteve financiare dhe menaxhimit financiar, kjo arrihet përmes kontrollit, monitorimit dhe sigurimit të cilësisë.

Rëndësia e kryerjes së auditimit në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit, ka të bëjë që të:

- sigurojë cilësi në auditimet e kryera;
- forcojë besueshmërinë e palëve të interesit në raportet e auditimit;
- rrisë transparencën e procesit të auditimit.

Sistemi ynë i menaxhimit të cilësisë bazohet në kërkesat e Standardeve Ndërkombëtare për Menaxhimin e Cilësisë, SNISA-t 140. Ne jemi të përkushtuar të ofrojmë punë audituese me cilësi të lartë përmes Udhëzuesve të Auditimit, rregulloreve dhe akteve të tjera me të cilët operon ZKA. Këto udhëzime rregullojnë metodologjinë e kryerjes së auditimeve dhe ofrojnë informata dhe udhëzime të mjaftueshme për t'i ndihmuar auditorët gjatë procesit të auditimit të punojnë në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA), parimet e INTOSAI, dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA) si dhe udhëzimet e përshkuara në Kornizën e Deklaratave Profesionale të INTOSAI (KDPI).

Në të gjitha auditimet që kryhen, menaxhimin e cilësisë ZKA e siguron përmes 3 (tre) komponentëve; kontrolli i cilësisë, monitorimi i cilësisë dhe sigurimi i cilësisë i cili kryhet në disa nivele, duke u nisur nga udhëheqësit e auditimit, Drejtori i Auditimit si dhe Ndihmësit e Auditorit të Përgjithshëm. Përveç kësaj ZKA-ja ka të themeluar edhe Departamentin për Metodologji dhe Departamentin për Sigurimin e Cilësisë në Auditim, me qëllim të ngritjes së cilësisë së auditimeve në një nivel sa më të lartë. Ky departament, i cili vepron në pajtim me SNISA-t 140 (Kontrolli i cilësisë), kryen rishikimin planifikimeve dhe auditimeve të realizuara.

Përzgjedhja e auditimeve për rishikim nga ky departament, gjatë vitit 2023 ka pasur parasysh madhësinë, kompleksitetin e auditimeve dhe mbulueshmërinë e të gjitha ekipeve të auditimit në procesin e rishikimit të dosjeve të auditimit.

Për sezonin auditues 2022/2023 janë kryer 46 rishikime të auditimeve të rregullsisë, prej tyre janë kryer 8 rishikime për fazën e planifikimit, si dhe 31 rishikime për fazën e ekzekutimit dhe raportimit. Vlen të theksohet se në këtë sezonë audituese janë kryer edhe 7 rishikime të ftohta.

Për sezonin 2023/2024 për fazën e planifikimit janë kryer 32 rishikime të cilësisë.

Për auditimet e performancës, monitorimi dhe kontrolli i cilësisë është një proces që zbatohet në çdo auditim. Fazat e planifikimit, ekzekutimit dhe raportimit të auditimit janë subjekt i rishikimit në të gjitha nivelet menaxheriale. Rishikimi kolegial për memorandumit e parastudimit dhe draft-raportin e auditimit bëhet nga anëtarët e emëruar (auditorë me përvojë) brenda divizionit. Për disa nga temat janë angazhuar këshilltarë të jashtëm nga Zyra Kombëtare e Auditimit të Suedisë (SNAO).

3.7. Bashkëpunimi me organet e sundimit të ligjit

Me qëllim të forcimit të sundimit të ligjit dhe për të rritur përgjegjshmërinë në sektorin publik, në pajtim me standardet e auditimit dhe me legjislacionin e fushës penale, gjatë këtij viti kemi dërguar 51 raste me elemente potenciale të veprave penale, mashtrimit dhe korrupsionit në Prokurori të Shtetit. Rastet janë identifikuar gjatë ushtrimit të aktivitetëve audituese dhe rrjedhin kryesisht nga fusha e prokurimit, pa i përjashtuar edhe fushat tjera. Po ashtu janë dërguar edhe 3 raporte¹³ në tërësi.

Në raport me organet e drejtësisë dhe organizmat përkatëse për luftimin e korrupsionit kemi avancuar mënyrat e komunikimit, si dhe të shkëmbimit të informacioneve me Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit.

13 Raporti për AKP-së dhe Raporti i Performancës, Prokurimet e negociuara pa publikim të njoftimit për kontratë në Ministrinë e Ministrinë: Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës në vitin 2021. Komunitat: K_DEC, K_FE, K_FK, K_GJL, K_GJK, LKL, K_KLL, K_MT, K_OB, K_PO, K_PR, K_PZ, K_RAH, K_VU, K_VIT, K_SK, K_SHT. Ministrinë: Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sporteve, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës. Institucione tjera janë: AKP, Fondi i Sigurimeve Shëndetësore, Agjencia e Shoqërisë së Informacionit.

Menaxhimi Financiar dhe Administrativ

04

4.1. Menaxhimi financiar

ZKA-ja financohet nga buxheti i shtetit dhe si i tillë menaxhohet dhe shpenzohet me një përgjegjësi dhe llogaridhënie të lartë. Bazuar në Ligjin Nr. 08/L-066 mbi ndarjet buxhetore për vitin 2023, mjetet e ndara për ZKA-në ishin në shumë prej 3,266,591€.

Buxheti ishte i ndarë në katër kategori ekonomike, si në vijim:

- Paga dhe shtesa në vlerë 2,414,491€;
- Mallrave dhe Shërbimeve në vlerë 738,100€;
- Shërbimeve komunale në vlerë 40,000€ dhe
- Investimeve kapitale në vlerë 74,000€.

Përderisa buxheti final në fund të vitit ishte 3,051,645€.

Me vendim të Qeverisë së Kosovës Nr. 69/2023 të datës 27.12.2023, bazuar në Nenin 15 paragrafi 9 i Ligjit Nr.08/L-193 mbi ndarjet buxhetore për vitin 2023, Zyrës Kombëtare të Auditimit në kategorinë "Paga dhe Shtesa" i është zvogëluar buxheti prej 241,868€ si tepriçë buxhetore si shkak i dorëheqjeve dhe pensionimeve të stafit, përderisa tek kategoria mallra dhe shërbime është rritur buxheti final për 26,921€ donacion për mirëmbajtjen e databazës për rekomandimet e dhëna gjatë procesit, me datë 28.12.2023.


Gjatë vitit 2023, ZKA ka realizuar të hyra jo-tatimore nga ofrimi i shërbimeve audituese, që rrjedhin nga marrëveshja me Organizata ndërkombëtare, si SIDA suedeze dhe Helvetas Swiss Intercooperation Kosova (DEMOS). Totali i të hyrave jo-tatimore ishte 15,682€.

Buxheti total i shpenzuar gjatë viti 2023 në të gjitha kategoritë ekonomike ishte në vlerë 2,876,913€, apo 94% e buxhetit final.

Tabela 9. Shpenzimi i buxhetit përgjatë tri viteve 2023-2021 (në EUR `000)


Raporti i buxhetit	Buxheti fillestar	Buxheti Final	Buxheti i shpenzuar	%
2023				
Buxheti i përgjithshëm	3,267	3,052	2,877	94%
Pagat dhe shtesat	2,414	2,173	2,171	100%
Mallrat dhe shërbimet	738	765	633	83%
Shërbimet komunale	40	40	36	89%
Investimet kapitale	74	74	37	50%
2022				
Buxheti i përgjithshëm	3,066	3,046	2,785	91%
Pagat dhe shtesat	2,291	2,291	2,154	94 %
Mallrat dhe shërbimet	685	685	572	84%
Shërbimet komunale	40	40	35	88%
Investimet kapitale	50	30	24	80%
2021				
Buxheti i përgjithshëm	2,796	2,791	2,750	99%
Pagat dhe shtesat	2,088	2,192	2,192	100%
Mallrat dhe shërbimet	605	510	475	93%
Shërbimet komunale	50	36	34	92%
Investimet kapitale	53	53	49	93%

Grafiku 1. Shpenzimet nëpër kategori ekonomike nëpër vite 2023-2021




Grafiku 2. Shpenzimet nëpër kategori ekonomike për vitin 2023

Përqindja e shpenzimeve nëpër kategori ekonomike



Shuma më e madhe e buxhetit final të ZKA-së krahas shpenzimeve totale shpenzohet në kategorinë e Pagave dhe Shtesave 75.46 %, pastaj në kategorinë e Mallrave dhe Shërbimeve arrin 22%. Përderisa tek Shpenzimet Komunale dhe Investimet Kapitale përqindja e shpenzimit është 1%.

Grafiku 3. Shpenzimet krahas buxhetit final nëpër kategorive ekonomike 2023




Krahas buxhetit final nëpër kategori ekonomike në përqindje kategoria e pagave dhe shtesave është shpenzuar 100%, Shërbimet Komunale 90%, Mallrat dhe Shërbimet 83% dhe Investimet Kapitale 50%.

- Në **Paga dhe shtesa** është miratuar ndarja buxhetore në vlerë 2,414,491€, përderisa numri i miratuar i personelit ishte 180 pozita. Buxheti i shpenzuar në paga dhe shtesa është 2,172,624€ apo 100% e buxhetit final. Përderisa mjetet e marra me vendim të qeverisë, si mjete të pashpenzuara ishin 241,867€ apo 11% e buxhetit fillestar me ligjin e buxhetit.

Përqindja më e ulët e shpenzimeve në këtë kategori ekonomike gjatë vitit 2023 sesa buxheti i aprovuar ka ardhur për arsytet si në vijim:

- Njëmbëdhjetë (11) nëpunës gjatë 2023 kanë dhënë dorëheqje nga ZKA dhe
- Katër (4) nëpunës gjatë 2023 janë pensionuar.
- Në **Mallra dhe Shërbime** është miratuar ndarja buxhetore 738,100€, përderisa pas alokimit edhe të donacionet të SAI të Arabisë Saudite buxheti final ishte 765,021€. Shpenzimet në këtë kategori në fund të vitit 2023 ishin 633,486€ apo 83% e buxhetit final.

Grafiku 4. Shpenzimet kryesore në kategorinë mallra dhe shërbime gjatë vitit 2023



Shpenzimet për zëra me shpenzime më të mëdha (emërtim) të shprehur në % në këtë kategori janë:

- Qiraja për objektin ku ndodhet selia e ZKA-së, qira për pajisje (fotokopjeve) dhe hapësirave tjera vazhdon të paraqes njërën prej shpenzimeve më të mëdha në Kategorinë e Mallrave dhe Shërbimeve me vlerë 166,215€ apo 26%;
- Mirëmbajtjet-ku përfshihen mirëmbajtja higjienike dhe sigurimi fizik i selisë së ZKA-së, mirëmbajtja e pajisjeve të teknologjisë informative dhe mirëmbajtja e automjeteve zyrtare të ZKA-së, janë shpenzuar 172,768€ apo 27%;
- Shpenzimet intelektuale këshilldhënëse-ku përfshihen shpenzimet për auditimin e komunave dhe institucioneve të pavarura janë 32,641€ apo 5%;
- Shpenzimet që ndërlidhen me edukimin profesional të stafit, shënimin e 20 vjetorit të themelimit të ZKA-së, organizimin e tryezave dhe punëtorive të ndryshme, si dhe shpenzimet e reprezentacionit, furnizim me ujë të pijshëm, etj janë 122,251€ apo 19%.
- Shpenzimet për naftë për nxemje qendrore për objektin e ZKA-së bashkë me shpenzimet e naftës për veturat zyrtare- janë 37,202€ apo 6%;
- Shpenzimet e udhëtimit brenda dhe jashtë vendit-përfshin shpenzimet për mëditje dhe akomodim të menaxhmentit dhe stafit të ZKA-së gjatë udhëtimeve zyrtare brenda dhe jashtë vendit. Në total shpenzimet në

këta zëra arrijnë vlerë prej 76,138€ apo 12%. Këtu përfshihen 20,181€ apo 3.2% udhëtimet zyrtare brenda vendit, të cilat përfshijnë kompensimin e ushqimit dhe akomodimin në funksion të kryerjes së veprimtarisë audituese në terren në entitetet të cilat janë larg Prishtinës më shumë se 55km.

Përderisa 55,957€ apo 8.8% prezantojnë shpenzimet për udhëtimet zyrtare jashtë vendit. Këto shpenzime prezantojnë pjesëmarrjen më të madhe të stafit (63 sosh vetëm gjatë 2023) në përfaqësime të ndryshme, si: në trajnime, vizita studimore, konferenca me qëllim të ngritjes profesionale, angazhime në ndarjen e përvojave për auditime të shpejta, në kohë reale, investigative, etj. Mandej, pjesëmarrja në auditimin e ambasadave të Republikës së Kosovës, pjesëmarrjes në auditimet paralele me ISA-të partnere jashtë Kosovës si dhe pjesëmarrjen në takimet me partnerët tanë ndërkombëtarë me financim nga donatorët. Ndërkohë që ZKA ka marrë përsipër vetëm mbulimin e mëditjeve/parasë se xhepit që për rrjedhojë paraqesin shpenzimet minimale për realizimin e një përfaqësimi.

- Në **Shërbimet Komunale** është miratuar ndarja buxhetore në vlerë prej 40,000€. Buxheti është shpenzuar në vlerën prej 35,741€ apo 90%, përqindja më e lartë në këtë kategori është shpenzimi i rrymës që përfshin 77% e të gjitha shpenzimeve.
- Në **Investime Kapitale** është miratuar ndarja buxhetore në vlerë 74,000€ për katër (4) projekte kapitale. Shpenzimet finale në këtë kategori ekonomike ishin në vlerë 36,890€, apo 50 % e totalit të buxhetit final. Shpenzimet kanë të bëjnë me rifreskimin e infrastrukturës së TI-së në objektin e ZKA-së, blerjen e dy pajisjeve me qëllim të rritjes së hapësirës për ruajtjen e shënimeve në serverët ekzistues si dhe zhvillimi i web-faqes së re të Internetit së bashku me data bazën e të dhënave për implementim të rekomandimeve.

Projekti për furnizim me vetura zyrtare ka dështuar të implementohet gjatë 2023 si shkak i mos përfundimit të procedurave tenderuese të udhëhequra nga AQP-ja.

Burimet Njerëzore

05

Mbështetur në Ligjin Nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës, ZKA ka të aprovuar kornizën e brendshme rregullative përmes së cilës rregullon menaxhimin dhe funksionimin e Burimeve Njerëzore. Departamenti për menaxhimin e burimeve njerëzore ofron përkrahje profesionale për të gjithë punonjësit e ZKA-së, rrjedhimisht ushtrimi i veprimtarisë është në përputhje të plotë me rregullativën ligjore në fuqi dhe me udhëzuesit dhe politika e INTOSAI dhe EUROSAI.

5.1. Burimet Njerëzore

Burimet Njerëzore janë aseti më i rëndësishëm në organizatë. ZKA ofron mjedis bashkëpunues institucional, të vlerësuar, me staf të përgatitur profesionalisht, të përkushtuar dhe motivuar me qëllimin që të përmbushim obligimet tona ligjore, të arrijmë rezultatet dhe demonstrojmë vlerat tona institucionale.

ZKA procesin e rekrutimit dhe statusin e të punësuarit e ka të rregulluar në përputhje me parimet e përcaktuara me Ligjin përkatës dhe duke i marrë parasysh vlerat dhe parimet e legjislacionit në fuqi që rregullojnë marrëdhënien e punës.

Struktura e personelit ndahet në pesë (5) kategori, si:

- Kategori e lartë drejtuese;
- Kategori e mesme drejtuese;
- Kategori e ulët drejtuese;
- Kategori profesionale dhe
- Kategori mbështetëse.

Struktura e numrit të përgjithshëm të personelit përbehet prej 79% personel auditues (përfshirë pozitat drejtuese), dhe 21% janë punonjës të shërbimeve profesionale mbështetëse (përfshirë pozitat drejtuese).

Në vitin 2023, ZKA-ja ka rekrutuar dymbëdhjetë (12) punonjës në nivelin profesional, si dhe një (1) punonjës është angazhuar në Kabinetin e Auditorës së Përgjithshme.

Marrëdhënien e punës e kanë shkëputur njëmbëdhjetë (11) punonjës si dhe katër (4) kanë arrit moshën e pensionimit. ZKA në fund të vitit 2023 kishte 163 punonjës.

Tabela 9. Personeli i ZKA-së, përgjatë tri viteve të fundit

Viti	Numri i personelit në fund të vitit	Personeli Gjinia Femërore (%)	Personeli Gjinia mashkullore (%)	Mosha Mesatare (vite)	Numri i personelit nga komunitetet	Lëvizja e personelit %
2023	163	56%	44%	43	3	7%
2022	166	55%	45%	43	4	4%
2021	164	52%	58%	43	4	4%

Në tabelë janë paraqitur të dhënat rreth nëpunësve, ku përfshihet numri i përgjithshëm i nëpunësve, përqindja sipas gjinisë, mosha mesatare, numri i nëpunësve nga komunitetet si dhe përqindja e lëvizjeve/largimeve.

Mosha mesatare e nëpunësve të ZKA-së është 43 vjet, prej tyre të moshës prej 25 deri në 50 vjet janë 80% kurse 20% janë të moshës prej 51 deri në 64 vjet.

Në strukturën udhëheqëse të ZKA-së përfshihen:

- Kategoria e lartë drejtuese (Zëvendës Auditori i Përgjithshëm, Ndhmës Auditorët e Përgjithshëm dhe Drejtori i Përgjithshëm) nga gjithsej 7 pozita prej tyre dy (2) femra dhe pesë (5) meshkuj;
- Kategoria e Mesme dhe Ulët Drejtuese (Drejtorët e Departamentit të Auditimit, Drejtori i Auditimit të Brendshëm, Drejtorët dhe Udhëheqësit e Divizioneve në Shërbimet Përkrahëse e Administrative) nga gjithsej 26 pozita, 13 pozita janë femra dhe 13 pozita janë meshkuj.

Personeli Auditues – Në strukturën e përgjithshme të personelit në institucion, stafi auditues profesional përbën pjesën më të madhe të stafit.

Kategoria profesionale audituese përbëhet nga pozitat si në vijim:

- Auditor Specialist;
- Auditor Senior në auditim financiar dhe pajtueshmërisë, auditim të performancës dhe auditim të teknologjisë së informacionit;

- Auditor në auditim financiar dhe pajtueshmërisë, auditim të performancës dhe auditim të teknologjisë së informacionit;
- Auditor junior në auditim financiar dhe pajtueshmërisë dhe auditim të performancës.

Tabela 10: Pozitat në kategoritë audituese profesionale sipas viteve 2021-2023

Viti	Financiar & Pajtueshmëri			Performancë (Prokurim & TI)			Auditor Specialist
	Auditor Senior	Auditor	Auditor Junior	Auditor Senior	Auditor	Auditor Junior	
2023	51	15	19	10	3	6	7
2022	56	15	17	13	1	6	5
2021	66	21	15	13	4	8	6

Të dhënat e mësipërme pasqyrojnë se ZKA ka një staf kompetent, me profilet e duhura akademike dhe profesionale për të kryer punën audituese.

Zhvillimi i karrierës në kuadër të ZKA-së është i përcaktuar me rregullore dhe përfshin lëvizjen brenda kategorisë, lëvizja e auditorëve brenda kategorisë profesionale si dhe ngritja në detyrë.

Të gjitha proceset e zhvillimit në karrierë dhe promovimit janë të rregulluara me procedurë të shkruar. Në vitin 2023 në Zyrën Kombëtare të Auditimit janë promovuar gjashtë (6) Auditorë në nivelet profesionale: Auditorë dhe Auditorë Senior.

5.2. Zhvillimi profesional dhe trajnimi i personelit

Zhvillimi profesional është objektiv kryesor dhe i vazhdueshëm i ZKA-së duke përkrahur dhe investuar tek personeli auditues dhe jo auditues, që në mënyrë direkte rezulton në arritjen e objektivave strategjike në mënyrë profesionale në proceset audituese. Kjo qasje ka për qëllim që personeli ynë të ketë shkathtësitë dhe kapacitetet e duhura për të përmbushur detyrat e përcaktuara në realizimin e objektivave audituese dhe mandatin ligjor.

Tabela 12. Auditorët e certifikuar nëpër nivele në skemat e certifikimit

Nivelet e certifikimit	Auditor i certifikuar i sektorit publik	Auditor i sektorit publik	Asistent i Auditorit i certifikuar i sektorit publik	Auditorët e certifikuar të TI-së	Auditor i certifikuar i performancës
Numri i auditorëve	88	14	3	3	18

ZKA ka investuar në certifikimin e stafit auditues dhe edukimit të vazhdueshëm profesional në hap me zhvillimet ndërkombëtare në fushën e kontabilitetit dhe auditimit. Në skemën e certifikimit publik nëpër nivele janë certifikuar 105 auditorë, prej tyre 88 auditorë të certifikuar në sektorin publik, 14 auditorë të sektorit publik dhe 3 asistentë i auditorit në sektorin publik.

Për auditimet e performancës janë certifikuar 18 auditorë në kuadër të një programi për Zhvillimin e Kapaciteteve Institucionale ndërmjet SNAO dhe ZKA. Po ashtu, ZKA në fushën e Auditimeve të Teknologjisë të Informacionit janë 3 auditor të certifikuar dhe një (1) auditor është në proces të certifikimit. Po ashtu, 2 auditor u certifikuan si "Auditorë të Certifikuar nga IDI".

Stafi i ZKA-së, njohuritë profesionale ekzistuese i plotësojnë përmes ndjekjes së trajnimeve, ku fillimisht kryhet identifikimi i nevojave për trajnim të stafit që kryesisht bëhet gjatë vlerësimit vjetor të performancës. Në bashkëpunim me departamentet përkatëse, Departamenti për Burime Njerëzore koordinon aktivitetet për hartimin dhe zbatimin e Planeve të Trajnimit çdo vit.

Plani i trajnimeve për vitin 2023 përbëhet nga trajnimet e brendshme dhe jashtme. Trajnimet e brendshme zhvillohen në dy periudha të ndarë në dy sesione (Sesioni Janar-Shkurt dhe Sesioni Shtator).

Plani i trajnimeve është zhvilluar me një sistem të kombinuar përmes platformave online, qasjes fizike, seminareve virtuale dhe pjesëmarrjes nëpër konferenca e ngjarje të ndryshme. Kjo përfshin edhe pjesëmarrjen në trajnime në kuadër të edukimit të vazhdueshëm profesional (EVP), të cilën ZKA e ka të rregulluar përmes dy shoqatave profesionale në fushën e kontabilitetit dhe auditimit.

Gjatë vitit 2023, janë zhvilluar 57 aktivitete të ndryshme (trajnime, punëtori, vizita studimore), mirëpo ato që veçohen janë:

- Shkrimi i qartë i raportit të Auditimit;
- Qasja e Auditimit të pasurisë (Menaxhimi i pasurisë);
- Auditimi Digjital dhe Përgatitja për Emergjenca;
- Lidershipi dhe zhvillimi i aftësive të buta;
- Përdorimi i gjuhës së thjeshtë;
- Menaxhimi i Pasurisë në Sektorin Publik;
- Avansimi i Digjitalizimit përmes Menaxhimit Financiar;
- Korniza e deklaratave profesionale të auditimit dhe ndryshimet;
- Procesi i auditimit në softuerin SITA;
- Prezantimi i planit kontabël të përditësuar dhe udhëzuesit të planit kontabël;
- Mostrimi në auditimin financiar dhe të pajtueshmërisë;
- Zhvillimi i njohurive tek procedurat substanciale edhe të pajtueshmërisë;
- Planifikimi Financiar në Sektorin Publik dhe Privat;
- Auditimi i së ardhmes së barabartë;
- Edukimi Profesional për Auditorë (PESA – P);
- Programi i trajnimit për auditimet e performancës në nivel regjional;
- E – Prokurimi;
- E – Pasuria

Përveç programeve të trajnimit stafi i Zyrës Kombëtare të Auditimit në vazhdimësi realizon takime e sesione këshilluese ku përfiton njohuri nga praktika e ekspertëve me të cilët Zyra Kombëtare e Auditimit ka Marrëveshje Bashkëpunimi si: Zyra Kombëtare e Auditimit të Suedisë, IDI, PESA-P, Bashkimi Evropian, Ambasada e Mbretërisë Holandeze, OSBE, USAID, Ministria e Financave e Republikës së Kosovës, KRPP, Banka Botërore, Projekti i Ambasadës të Britanisë së Madhe në Republikën e Kosovës i implementuar nga BDO. etj.

Fotogaleria 1. Trajnimet për stafin ZKA-së.



5.3. Shërbimet e përbashkëta

Departamenti për shërbime të përbashkëta, përmes divizioneve përkatëse, ofron shërbime përkatëse për personelin e ZKA-së. Në kuadër të këtij departamenti janë: divizioni për logjistikë, divizioni për administrim të dokumenteve zyrtare dhe divizioni për përkthime.

- **Divizioni për logjistikë** ofron mbështetje të vazhdueshme për ekipet audituese, duke ofruar shërbime të transportit si dhe të përkrahjes përmes furnizimeve të materialeve të nevojshme për punë në zyrë. ZKA disponon njëmbëdhjetë (11) vetura zyrtare, shtatë (7) nga të cilat janë plotësisht të amortizuara.

Vlera totale e pasurive kapitale në fund të vitit 2023 ishte 351,254€. Në shumën e përgjithshme janë përfshirë edhe blerjet e reja gjatë vitit 2023 dhe atë: blerja e dy paisjeve për krijim të hapësirës më të madhe në serverët tanë për ruajtje të shënimeve, një serveri për përforcim të infrastrukturës së telekomunikimit në objektin e ZKA-së. si dhe dizajnimi i web-faqes së re të ZKA-së.

Vlera totale e pasurive jokapitale në fund të vitit 2023 ishte 68,725€. Në shumën e përgjithshme janë përfshirë edhe blerjet e reja gjatë vitit 2023.

Tabela 13. Pasuritë kapitale dhe jokapitale ndër vite

Viti	2023	2022	2021
Pasuritë kapitale mbi 1,000€	351,254	380,526	419,535
Pasuritë kapitale nën 1,000€	68,725	77,258	91,183

Ulja e vlerës neto të pasurive kapitale (mbi 1,000€) dhe jokapitale (nën 1,000 €) përgjatë viteve është si rezultat i amortizimit të tyre.

Në fund të vitit, me vendim të Auditorës së Përgjithshme është themeluar komisioni për inventarizim të pasurive të ZKA-së, i cili ka përgatitur dhe dorëzuar raportin e inventarizimit, ku janë evidentuar konkluzione dhe rekomandimeve rreth pasurive të ZKA-së.

- **Divizioni për administrimin e dokumenteve zyrtare** në bashkëveprim me departamentin e TI-së ka vazhduar me menaxhimin/arkivimin elektronik të dokumenteve zyrtare. Përmes platformës elektronike, auditorët kanë qasje në dokumentet e arkivuara, të cilat janë të nevojshme për punët vijuese në auditim. Në vitin 2023, ky divizion ka protokolluar 2,290 dokumente të ndryshme.
- **Divizioni për përkthime** ofron shërbimin e përkthimit të dokumenteve zyrtare në gjuhën angleze dhe serbe, dhe anasjelltas, si dhe përkthimin e drejtpërdrejt në takimet dhe punëtoritë e organizuara nga ZKA. Për të mbuluar volumin e madh të nevojave për përkthim të dokumenteve brenda afateve, edhe gjatë vitit 2023 është angazhuar një operator i jashtëm për ofrimin e përkrahjes në përkthimin e raporteve të auditimit.

5.4. Teknologjia informative

Departamenti për Teknologji të Informacionit në ZKA është përgjegjës për menaxhimin e tërë infrastrukturës së TI-së, rrjedhimisht mbi këtë bazë në vazhdimësi ka përkrahur personelin e ZKA-së që të arrijë të përmbush objektivat e përcaktuara vjetore.

Departamentit i TI-së, ka siguruar që infrastruktura të jetë e rifreskuar në mënyrë që të përkrahë aplikacionet e biznesit sikur që është SITA.

Sfidë për Departamentin e TI në ZKA në vitin 2023 ishin dhe do të mbesin edhe për një kohë:

- menaxhimi i sigurisë kibernetike
- aplikimi i teknologjive të reja
- rekrutimi i stafit të TI sepse kërkesa për ta është e madhe në treg.

Ketë vit personeli i TI ishin në një vizitë studimore në Zyrën Kombëtare të Auditimit të Estonisë dhe gjatë qëndrimit atje, shkëmbyen njohuritë dhe përvojat në fushën e teknologjisë së informacionit dhe mjeteve digjitale mbështetëse në procesin e auditimit.

5.5. Prokurimi

ZKA, në përputhje me Planin Vjetor të Prokurimit të vitit 2023, ka zhvilluar gjithsej 39 aktivitete prokurimi të cilat kryesisht kanë qenë për furnizime dhe kryerje të shërbimeve.

Njësia e prokurimit në përputhje me informimin/njoftimin zyrtar nga KRPP nga data 01/02/2021, ndërlidhur me plotësim/ndryshimin A01 - Rregullat dhe Udhëzuesin Operativ për Prokurimin Publik (RRUOP) nr.001-2022, ka filluar në përdorim të dy moduleve të reja të sistemit të prokurimit elektronik “Modulin për menaxhim të kontratës” dhe “Modulin për vlerësim të performancës së kontraktuesve”.

**Komunikimi dhe
Bashkëpunimi me
Palët e jashtme**

06

6.1. Komunikimi dhe bashkëpunimi me palët e interesit

Me qëllim të informimit dhe për t'i ofruar publikut dhe palëve të jashtme njohuri më të mira për rolin dhe mandatin e saj, si dhe për të promovuar transparencën dhe llogaridhënien në menaxhimin e financave publike, angazhimi i ZKA-së me partnerët strategjikë dhe palët e interesit është i vazhdueshëm dhe konstruktiv.

Ndjekja e një qasje strategjike është thelbësor në arritjen e qëllimeve të institucionit, prandaj në dhjetor 2023, Auditorja e Përgjithshme ka miratuar Strategjinë për Komunikim të Zyrës Kombëtare të Auditimit 2023-2026, e cila ka dy qëllime strategjike që na udhëzojnë në arritjen e rezultateve të dëshirueshme. Qëllimi i parë është "Promovimi i rolit kushtetues të ZKA-së dhe rritja e ndikimit të rezultateve audituese në sektorin publik", ndërsa "Komunikim i brendshëm aktiv me qëllim të mbështetjes së punonjësve dhe promovimit të rezultateve të punës" është qëllimi i dytë i komunikimit.

Gjatë vitit 2023, ZKA-ja ka zhvilluar komunikim efektiv me publikun si dhe ka qenë pjesë aktive në shumë takime, punëtori dhe konferenca brenda dhe jashtë vendit duke kultivuar një bashkëpunim të ngushtë me partnerët si në nivel kombëtar ashtu edhe në atë ndërkombëtar.

Në aspektin kombëtar, kemi forcuar partneritetin tonë me Kuvendin e Republikës së Kosovës, respektivisht me komisionet parlamentare, organizatat e shoqërisë civile, me Institucionet akademike si dhe me shoqatat profesionale. Në sferën ndërkombëtare kemi avancuar dhe forcuar bashkëpunimin bilateral me Institucionet Supreme të Auditimit, ndërsa në fokus ka qenë edhe pjesëmarrja aktive në takime, punëtori dhe aktivitete të tjera në kuadër të EUROSAI-t dhe INTOSAI-t, si dhe në nivel regional në kuadër të Rrjetit të Institucioneve Supreme të Auditimit të vendeve kandidatë dhe kandidatë të mundshme për anëtarësim në BE.

6.2. Bashkëpunimi me Kuvendin e Republikës së Kosovës

Në përputhje me detyrimet ligjore për raportim por edhe në aspektin e partneritetit për të rritur ndikimin dhe shkallën e zbatimit të rekomandimeve të auditimit në mbështetje të llogaridhënies dhe qeverisjes së mirë. Bashkëpunimi është intensifikuar kryesisht përmes punës me Komisionin për Mbikëqyrje të Financave Publike (KMFP) dhe Komisionin për Buxhet, Punë dhe Transfere (KBPT).

Sipas detyrimeve dhe mandatit ligjor, Auditorja e Përgjithshme i ka dorëzuar Kuvendit, Raportin Vjetor të Performancës së Zyrës Kombëtare të Auditimit për vitin 2022, Raportin Vjetor të Auditimit për vitin 2022, 123 raporte të auditimit si dhe Planin Vjetor të Punës 2023/2024.

Auditorja e Përgjithshme ka prezantuar në seancë plenare gjetjet dhe rekomandimet e Raportit Vjetor të Auditimit për vitin 2022. Ky Raport përfshin opinionin e auditimit për Pasqyrat e Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2022 dhe përmbledhjen e rezultateve kryesore të punës audituese për sezonin auditues 2022/2023.

Gjatë vitit 2023 KMFP ka shqyrtuar 32 raporte të auditimit dhe ka nxjerrë 11 rekomandime për organizatat buxhetore, ndërsa KBPT ka shqyrtuar një raport të auditimit të performancës (Të hyrat nga qiraja në Agjencinë Kosovare të Privatizimit për periudhën 2012-2021). Poashtu, gjatë shqyrtimit të raporteve të punës së institucioneve të cilat i raportojnë Kuvendit ka marrë për bazë edhe raportet e auditimit.

ZKA-ja në vazhdimësi ka përgatitur përmbledhjet e raporteve të auditimit dhe informatat e nevojshme për KMFP-në dhe KBPT-në, si dhe ka mbështetur deputetët me informata dhe këshilla profesionale gjatë shqyrtimit të raporteve të auditimit në komisione parlamentare.

Në kuadër të intensifikimit të bashkëpunimit me Kuvendin janë mbajtur disa aktivitete të përbashkëta si:

- Punëtorja “Rritja e Bashkëpunimit ndërmjet Institucioneve Supreme të Auditimit dhe organeve kundër korrupsionit në Kosovë” në bashkëpunim me Zyrën e Kombeve të Bashkuara për Drogë dhe Krim (UNODC) dhe
- Tryezë pune për prezantimin e raportit “Rishikimi ndërkolegial i performancës së Zyrës Kombëtare të Auditimit të Kosovës” në bashkëpunim me SIGMA.

Fotogaleria - Bashkëpunimi me Kuvendin e Republikës së Kosovës/Prezantimi i RVA në seancë dhe KMFP



Prezantimi i RVA-së në seancë plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës



Prezantimi i RVP-së në KMFP



Prezantim i RVA-së 2022 në KMFP

6.3. Bashkëpunimi ndërkombëtar me ISA-të partnere dhe Marrëveshjet Bilaterale

Me rastin e shënimit të 20-vjetorit të themelimit, Zyra Kombëtare e Auditimit të Republikës së Kosovës në muajin tetor 2023 ka mbajtur Konferencën Tematike Ndërkombëtare “Roli i Institucioneve Supreme të Auditimit në të mirë të qytetarëve”.

Në këtë konferencë morën pjesë përfaqësues të lartë nga Institucionet Supreme të Auditimit nga Suedia, Portugalia, Turqia, Shqipëria, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi, Italia, Kroacia dhe Çekia. Po ashtu pjesëmarrës ishin edhe ish Auditorët e Përgjithshëm të Kosovës, përfaqësuesit e institucioneve publike të Kosovës, përfaqësues të organizatave ndërkombëtare dhe donatorë në Kosovë.

Në margjinat e shënimit të 20-vjetorit të ZKA-së, është mbajtur edhe Seminari për auditime të pajtueshmërisë i organizuar nga Zyra Kombëtare e Auditimit e Kosovës me mbështetjen e SIGMA-s në kuadër të Rrjetit të vendeve candidate dhe candidate të mundshme për anëtarësim në Bashkimin Evropian. Seminari mbledhi përfaqësues të Institucioneve Supreme të Auditimit nga vendet anëtare të Rrjetit, si: Shqipëria, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi, Bosnja dhe Hercegovina, si dhe përfaqësues të SIGMA-së dhe të Zyrës Kombëtare të Auditimit të Suedisë dhe asaj të Kosovës.

Auditorja e Përgjithshme priti në takime bilaterale homologët nga Portugalia, Suedia, Turqia si dhe delegacionin e Kroacisë. Këto takime u realizuan në kuadër të shënimit të 20-vjetorit të Zyrës Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës.

Fotogaleria - Konferenca Tematike Ndërkombëtare “Roli i Institucioneve Supreme të Auditimit në të mirë të qytetarëve”



*Konferenca Tematike Ndërkombëtare
Institucioneve Supreme të Auditimit në
të mirë të qytetarëve*



*Prezantimi i raportit “Rishikimi
ndërkolegial i performancës së Zyrës
Kombëtare të Auditimit të Kosovës*



Prezantimi i raportit “Rishikimi ndërkolegial i performancës së Zyrës Kombëtare të Auditimit të Kosovës.”



Seminari për auditime të pajtueshmërisë



Takimi i AP-së me AP-në e Suedisë



Takimi i AP-së me AP-në e Portugalisë



Takimi i AP-së me AP-në e Turqisë



Takimi i AP-së me ZVAP-në e Kroacisë

Takimet e AP-së dhe marrëveshjet e bashkëpunimit me përfaqësuesit e institucioneve publike të vendit gjatë këtij viti kanë vazhduar përmes aktiviteteve dhe takimeve të ndryshme si dhe nënshkrimit të disa marrëveshjeve.

Me qëllim të forcimit të sundimit të ligjit në Republikën e Kosovës si dhe në pajtim me standardet dhe praktikat më të mira ndërkombëtare, Zyra Kombëtare e Auditimit dhe Prokurori i Shtetit kanë nënshkruar marrëveshjen e bashkëpunimit me të cilën përcaktohet mënyra e bashkëpunimit dhe bashkërendimit të aktiviteteve ndërinstitucionale dhe procedurave standarde në shkëmbimin e informacioneve lidhur me rastet potenciale që përmbajnë elemente të mashtrimit apo korrupsionit të cilat identifikohen gjatë ushtrimit të aktiviteteve audituese.

Po ashtu, ZKA-ja dhe Projekti DEMOS kanë nënshkruar marrëveshjen e bashkëpunimit për kryerjen e auditimit të performancës “Mekanizmat e sigurimit të cilësisë së të dhënave të raportuara mbi Sistemin e Menaxhimit të Performancës Komunale (SMPK) dhe Grantin e Performancës Komunale (GPK)” i cili përfshinë vlerësimin e përshtatshmërisë dhe efektivitetit të mekanizmave të sigurimit të cilësisë së të dhënave të raportuara të GPK dhe SMPK.

ZKA-ja në mars 2023 ka nënshkruar edhe marrëveshjen trepalëshe për realizimin e auditimit të përbashkët të performancës “Barazia gjinore dhe fuqizimi i grave në zonat rurale përmes përfshirjes së tyre në tregun e punës” për periudhën 2019-2023. Marrëveshja është nënshkruar nga Institucioni Suprem i Auditimit të Maqedonisë së Veriut, Kontrolli i Lartë i Shtetit të Shqipërisë dhe Zyra Kombëtare e Auditimit të Kosovës.

Në vazhdën e bashkëpunimit me shoqatat profesionale si dhe me qëllim të përkrahjes për zhvillimin e kapaciteteve dhe aftësive profesionale të stafit ZKA-ja ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me:

- Shoqatën e Kontabilisteve të Çertifikuar dhe Auditorëve të Kosovës (SHKÇAK);
- Institutin për Kontabilitet, Auditim dhe Financa (IKAF) si dhe
- Fakultetin Ekonomik të Kolegjit AAB dhe Institutin e AAB-së për Kontabilistë dhe Auditor të Certifikuar.

Gjithashtu ZKA-ja dhe Njësia Qendrore Harmonizuese në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve, kanë nënshkruar Memorandumin e Mirëkuptimit me qëllim të bashkëpunimit në përmirësimin e cilësisë së auditimit të brendshëm me fokus në qeverisjen, vlerësimin dhe menaxhimin e rrezikut, si dhe ngritjen e cilësisë së raporteve të auditimit të brendshëm.

Auditorja e Përgjithshme, Vlora Spanca, gjatë kësaj periudhe kohore ka mbajtur edhe disa takime me:

- Kryetarin e Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik;
- Ambasadorin e Suedisë në Kosovë;
- Drejtoreshën e Projektit nga USAID “Integriteti i Komunave të Kosovës”;
- Drejtorin e ri të Zyrës së Demokracisë dhe Qeverisjes në USAID;
- Përfaqësuesit e Ambasadës së Japonisë në Kosovë;
- Shefin e bashkëpunimit në Zyrën e Bashkimit Evropian në Kosovë;
- Ushtruesin e Detyrës së Drejtorit të Projektit të USAID –it “Integriteti i Komunave të Kosovës”;
- Përfaqësuesit e lartë të Institutit të Miratuar për Financa Publike dhe Kontabilitet (CIPFA);
- Përfaqësuesin e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm të Norvegjisë si dhe
- Përfaqësuesit e Rrjetit të OJQ-ve AVONET.

Po ashtu ZKA-në e ka vizituar një delegacion nga Institucioni Suprem i Auditimit të Malit të Zi, përfaqësuesit nga Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN), si dhe Këshilltari i Lartë (Kundër Korrupsionit) të Zyrës së Kombeve të Bashkuara për Drogë dhe Krim (UNODC).

Auditorja e Përgjithshme dhe përfaqësuesit e ZKA-së kanë marrë pjesë në konferenca, punëtori dhe aktivitete të ndryshme vendore si:

- Konferenca Vjetore “Rritja e mbikëqyrjes publike dhe llogaridhënies institucionale në Kosovë”;
- Takimi i rregullt “Bashkëpunimi i Institucioneve të Kosovës në Fushën e Prokurimit Publik në Kosovë”;

- Konferenca “Ndërtimi i Besimit, Forcimi i Komuniteteve: Konferenca mbi Transparencën e Qeverisjes Lokale”;
- Konferenca “Krijimi i vlerave – Porta e së ardhmes”;
- Konferenca “Sfidat e Ardhshme për Sistemin e Prokurimit Publik në Kosovë”;
- Konferenca ndërkombëtare “KosovaPAR2023”;
- Aktiviteti për shënimin e Ditës Ndërkombëtare të Kontabilistëve;
- Takimi me kryetarët e komunave në kuadër të Projekti DEMOS dhe në bashkëpunim me Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL);
- Samiti i Burimeve Njerëzore “Power to HR”; si dhe
- Punëtorja mbi mësimet e nxjerra nga procesi i programimit të IPA 2024.

Fotogaleria - Takimet e AP-së dhe marrëveshjet e nënshkruara



*Nënshkrimi i marrëveshjes së bashkëpunimit ZKA-Prokurori i Shtetit
Foto*



Takimi i AP-së me ambasadorin e Suedisë



Nënshkrimi i marrëveshjes së bashkëpunimit ZKA-NJQH



Nënshkrimi i marrëveshjes së bashkëpunimit ZKA-SHKÇAK



Nënshkrimi i marrëveshjes së bashkëpunimit ZKA-IKAF



Nënshkrimi i marrëveshjes së bashkëpunimit ZKA-AAB

6.4. Vlerësimet për ZKA-në nga palët e jashtme për vitin 2023

Performanca e ZKA-së për këtë vit ka qenë subjekt i vlerësimeve të disa mekanizmave ndërkombëtar e vendor karshi opinionit publik, nivelit profesional dhe zbatimit të standardeve ndërkombëtare të auditimit. Këto vlerësime Zyrën tonë e kanë renditur në nivele të larta pozitive.

Zyra Kombëtare e Auditimit është renditur institucioni me nivelin më të lartë të integritetit (me 83.3 nga 100 pikë) sipas vlerësimit të Sistemit të Integritetit Kombëtar në Kosovë, për vitin 2023 i realizuar nga Instituti Demokratik i Kosovës (KDI). Këto rezultate janë një dëshmi e angazhimit të palodhur, transparencës dhe standardeve të larta etike dhe profesionale në të cilat ZKA-ja mbështet punën e vet. Ky vlerësim është domethënës dhe na inkurajon të kultivojmë edhe më tutje vlerat e larta dhe integritetin institucional.

Raporti i rishikimit nga SIGMA-2023 - Vlerësimi më domethënës nga të gjitha ka qenë ai i rishikimit kolegial (peer review) i kërkuar nga Kuvendi i Kosovës (KMFP) dhe i kryer nga ekspertë të pavarur të SIGMA-s, në shtator 2023. Ky rishikim, në bazë të analizave dhe shqyrtimeve të punës së ZKA-së, posaçërisht për auditimet e 2022 ka vlerësuar se ZKA është duke përformuar në përputhje të plotë me standardet ndërkombëtare të auditimit dhe praktikat e mira evropiane. Rezultati i këtij rishikimi është vlerësimi më pozitiv i mundshëm ku vlerësuesit potencojnë se

ZKA ka ndërmarr veprime serioze në zhvillimin dhe përmbushjen e pritshmërisë së kornizës së deklaratave profesionale të INTOSAI për të ndërtuar një institucion të pavarur dhe të besueshëm.

Barometri Ballkanik rendit ZKA-në si institucionin më të besuar në nivel rajonal

- Këshilli për Bashkëpunim Rajonal publikoi Barometrin Ballkanik për vitin 2023 ku janë prezantuar të dhënat nga hulumtimi i opinionit publik për qëndrimet e qytetarëve dhe bizneseve të vendeve të rajonit për çështjet socio-ekonomike dhe shoqërore që ndikojnë në jetën e tyre të përditshme si dhe nivelin e besueshmërisë në institucionet publike dhe pavarësinë e tyre. Indikatorin matës për nivelin e besueshmërisë në institucionet publike tregon se Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës gëzon besimin më të lartë në nivel rajonal, me 55% krahasuar me Institucionet Supreme të Auditimit të vendeve të tjera të rajonit.

Barometri Ballkanik po ashtu tregon se 54% e qytetarëve të Republikës së Kosovës e perceptojnë Zyrën Kombëtare të Auditimit si institucion të pavarur nga ndikimi.

Gjithashtu, Barometri Ballkanik mati edhe perceptimin e qytetarëve në aspektin se sa institucionet publike përgjegjëse mbikëqyrin në mënyrë efektive punën e qeverive. Edhe në këtë aspekt, ZKA-ja mori notë pozitive ku 57% të të anketuarve në Kosovë besojnë se ZKA-ja mbikëqyr në mënyrë efektive qeverinë.

6.5. Komunikimi me mediat, qytetarët, organizatat e shoqërisë civile, donatorët dhe palë të tjera

ZKA-ja në vitin 2023 fokus të veçantë i ka dhënë edhe bashkëpunimit dhe partneritetit me mediat, Organizatat e Shoqërisë Civile, si dhe komunikimit me qytetarë. Ky komunikim është avancuar përmes konferencave, takimeve si dhe aktiviteteve të ndryshme.

- Konferenca për media - Auditorja e Përgjithshme gjatë kësaj periudhe kohore ka mbajtur katër (4) konferenca për media. Konferenca e parë është mbajtur në fillim të muajit shkurt ku janë prezantuar rezultatet dhe konkluzionet e auditimeve “Të hyrat nga qiraja në Agjencinë Kosovare të Privatizimit për periudhën 2012-2021” si dhe “Funksionimi i sistemit të Grantit të Performancës Komunale dhe projektet e financuara nga donatorët”.

- Konferenca e dytë është mbajtur në muajin maj me rastin e fillimit të publikimit të raporteve të auditimit për sezonin 2022/2023, ku janë prezantuar gjetjet dhe rekomandimet për tre raportet e performancës: “Prokurimet e negociuara pa publikim të njoftimit për kontratë në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës në vitin 2021”; “Mbështetja e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme nga MINT/KIESA”; si dhe “Sistemet e Informacionit në Kompaninë e Ujësjiellit Rajonal Prishtina”.
- Konferenca e tretë është mbajtur në fillim të muajit korrik në të cilën janë prezantuar rezultatet e auditimit për vitin 2022 përkatësisht gjetjet kryesore dhe rekomandimet për 97 raporte të auditimit financiar dhe të pajtueshmërisë dhe një raporti të auditimit të performancës.
- Konferenca e katërt është mbajtur në fillim të muajit shtator ku është prezantuar Raporti Vjetor i Auditimit (RVA) për vitin 2022, i cili përfshin opinionin e auditimit për Pasqyrat e Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin financiar 2022 dhe përmbledhjen e rezultateve kryesore të punës audituese përfshirë opinionin e auditimit, gjetjet dhe rekomandimet. Po ashtu në këtë konferencë është shpalosur edhe numri i rasteve të dyshimit për kryerjen e veprave penale të cilat janë dërguar te Prokurori i Shtetit.

Edhe këtë vit puna dhe rezultatet e auditimit kanë qenë më afër publikut me rritjen e prezencës së ZKA-së në media, duke u botuar rreth 1000 artikuj për raportet e auditimit dhe aktivitetet e AP-së dhe ZKA-së.

Po ashtu ZKA-ja ka vënë në dispozicion informatat e kërkuara nga organizatat e shoqërisë civile, mediat dhe qytetarët si dhe ka avancuar komunikimin në rrjetet sociale.

Gjithashtu web faqja e ZKA-së, si burimi kryesor i informacionit është përditësuar në vazhdimësi duke i ofruar qytetarëve qasje në të dhëna për raportet e auditimit. Brenda vitit janë regjistruar 357,852 vizitorë.

Fotogaleria – Konferencat për media të AP-së



Konferenca e AP-së 01.02.2023



Konferenca e AP-së 03.05.2023



Konferenca e AP-së 04.07.2023



Konferenca e AP-së 11.09.2023

Tryezat e organizuara nga ZKA-ja me palët e interesit dhe OSHC-të. Partneriteti me organizatat e shoqërisë civile, shoqatat profesionale dhe donatorët është fuqizuar. Në këtë linjë ZKA-ja në muajin korrik 2023 ka mbajtur tryezën “Auditimet e performancës në fokus të bashkëpunimit në mes të ZKA-së dhe shoqërisë civile” e cila kishte për qëllim identifikimin e çështjeve me interes publik për t’u audituar në sezonin auditues 2023/2024.

Po ashtu ZKA-ja në bashkëpunim me Zyrën e UN Women në Kosovë në muajin shtator ka mbajtur tryezë pune ku janë prezantuar rezultatet e auditimit të performancës “Efektiviteti i institucioneve në trajtimin e rasteve të dhunës në familje”. Qëllimi i kësaj tryeze përveç shpalosjes rezultateve të auditimit ishte edhe t’i mbledhë së bashku palët përgjegjëse për zbatimin e rekomandimeve. Në tryezë përveç drejtuesve më të lartë të ZKA-së dhe UN Women morën pjesë edhe Ministrja e Drejtësisë dhe Avokati i Popullit, të cilët shprehen domosdoshmërinë e marrjes së masave për zbatimin e rekomandimeve të auditimit.

Po në muajin shtator ZKA-ja në bashkëpunim me Zyrën e Kombeve të Bashkuara për Drogë dhe Krim (UNODC) mbajti tryezën “Rritja e Bashkëpunimit ndërmjet Institucioneve Supreme të Auditimit dhe organeve kundër korrupsionit në Kosovë”, në të cilën u tha së parandalimi dhe luftimi i korrupsionit kërkon bashkëpunim dhe koordinim efikas dhe efektiv në mes të institucioneve të mandatuara për luftimin e kësaj dukurie.

Ndërsa në muajin dhjetor në kuadër të javës kundër korrupsionit, Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA) me mbështetjen e USAID-it mbajti tryezën e punës “Roli i institucioneve publike në luftën kundër korrupsionit”, ku morën pjesë drejtues dhe përfaqësues nga Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit, Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, Inspektorati Policor i Kosovës, Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, GIZ-i si dhe nga shoqëria civile.

Në kuadër të aktiviteteve për mbështetjen e komunave, Zyra Kombëtare e Auditimit dhe OSBE-ja kanë mbajtur punëtorinë dyditore për vendosjen e mekanizmave mbikëqyrës në komuna për të rritur ndikimin e auditimit, ku trajtuan çështjet që ndikuan në opinionin financiar të auditimit, përkatësisht gjetjet kryesore të raporteve të auditimit për komunat për vitin 2022 si dhe sfidat kryesore për zbatimin e rekomandimeve.

Me qëllim të përmirësimit të performancës së organizatave buxhetore, Ministria e Financave, Punës, dhe Transfereve (MFPT) në bashkëpunim me Zyrën Kombëtare të Auditimit (ZKA), dhe me përkrahjen e programit të USAID për Qeverisje Ekonomike në Kosovë, në nëntor mbajtën punëtorinë “Ekzekutimi i buxhetit nga organizatat buxhetore dhe zbatimi i rekomandimeve të Zyrës Kombëtare të Auditimit”.

Fotogaleria – Tryezat e organizuara nga ZKA-ja me palët e interesit dhe OSHC-të



Tryeza ZKA-UN Women “Efektiviteti i institucioneve në trajtimin e rasteve të dhunës në familje”



Tryeza për luftën kundër korrupsionit “Roli i institucioneve publike në luftën kundër korrupsionit”



Tryeza “Auditimet e performancës në fokus të bashkëpunimit në mes të ZKA-së dhe shoqërisë civile”



Tryeza “Rritja e Bashkëpunimit ndërmje tInstitucioneve Supreme të Auditimit dhe organeve kundër korrupsionit në Kosovë”

6.6. Bashkëpunimi ndërkombëtar me ISA-të partnere, Marrëveshjet Bilaterale dhe pjesëmarrja në konferenca e punëtori ndërkombëtare

Krahas bashkëpunimit kombëtar dhe forcimit të kapaciteteve institucionale Zyra Kombëtare e Auditimit të Kosovës gjatë vitit 2023 është angazhuar në mënyrë aktive në avancimin e bashkëpunimit ndërkombëtar për të shkëmbyer praktikat më të mira dhe për të nxitur bashkëpunimin me homologët në nivel regjional dhe global. Përmes takimeve bilaterale, vizitave studimore, pjesëmarrjes në konferenca, punëtori si dhe anëtarësimit në programe dhe grupe të ndryshme të INTOSAI-t dhe EUROSAI-t, ZKA-ja ka avancuar paraqitjen e saj profesionale në arenën ndërkombëtare.

Auditorja e Përgjithshme Vlora Spanca, është pritur në takim të veçantë nga Presidenti i Gjykatës së Auditorëve të Italisë Guido Carlino, i cili ka shprehur gatishmërinë për bashkëpunim ndërinstitucional përmes zhvillimit të aktiviteteve bilaterale, si dhe në kuadër të EUROSAT-t dhe INTOSAT-t. Po ashtu delegacioni i ZKA-së gjatë vizitës në Romë ka marrë pjesë në takimin e parë të grupit punues mbi përfitimet dhe metodologjitë e auditimit në kohë reale, i cili operon nën qëllimin e parë strategjik të EUROSAT-t.

Auditorja e Përgjithshme Vlora Spanca dhe Zëvendës Auditori i Përgjithshëm Bezaq Halilaj, kanë marrë pjesë në Konferencën e dytë Rajonale të Autoriteteve të Auditimit të IPA-s në Stamboll.

Auditorja e Përgjithshme Vlora Spanca dhe Zëvendës Auditori i Përgjithshëm Bezaq Halilaj, kanë marrë pjesë në Simpoziumin Ndërkombëtar për Çështjet e Shfaqura, organizuar në Lisbonë nga Gjykata e Auditorëve të Portugalisë në partneritet me Zyrën Kombëtare të Auditimit të Mbretërisë së Bashkuar dhe nën kujdesin e Organizatës Evropiane të Institucioneve Supreme të Auditimit (EUROSAI).

Gjatë vitit 2023, Auditorja e Përgjithshme e Republikës së Kosovës Vlora Spanca ka qëndruar për vizitë zyrtare dhe është pritur në takime bilaterale nga homologët e saj në Kontrollin e Lartë të Shtetit (KLSH), në Institucionin Shtetëror të Auditimit të Malit të Zi, në Entin Shtetëror të Revizionit të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe në SNAO.

Po ashtu AP-ja ka marrë pjesë edhe në aktivitetet e organizuara në kuadër të shënimit të 98-vjetorit të themelimit të KLSH-së, Konferencën Shkencore të Institucionit Shtetëror të Auditimit të Malit të Zi për shënimin e 19-vjetorit të themelimit të këtij institucioni si dhe në punëtorinë për aftësitë e lidërshiptit.

Gjithashtu në muajin dhjetor 2023 Auditorja e Përgjithshme e Kosovës Vlora Spanca, mori pjesë në takimin e krerëve të Institucioneve Supreme të Auditimit të Rrjetit të Institucioneve Supreme të Auditimit të vendeve kandidate dhe kandidate të mundshme për anëtarësim në Bashkimin Evropian. Qëllimi i takimit ishte miratimi i Kornizës së re të bashkëpunimit në Rrjet si dhe diskutimi për Raportin e progresit për zbatimin e Planit të Punës së Rrjetit 2022-2025 dhe aktiviteteve të ardhshme, duke përfshirë prezantimin e aktiviteteve të kryera në kuadër të Programit të Trajnimit të Auditimit të Performancës.

Fotogaleria - Bashkëpunimi ndërkombëtar me ISA-të partnere, Marrëveshjet Bilaterale dhe pjesëmarrja në konferenca e punëtori ndërkombëtare



Takimi i AP-së me Presidentin e Gjykatës së Auditorëve të Italisë



AP në takimin e parë të grupit punues mbi përfitimet dhe metodologjitë e auditimit në kohë reale, i cili operon nën qëllimin e parë strategjik të EUROSAI-t



Takimi i AP-së me AP-në e Malit të Zi




Takimi i AP-së me AP-në e Maqedonisë së Veriut



Takimi i AP-së me AP-në e Shqipërisë dhe Maqedoninë e Veriut



AP në Konferencën Shkencore të ISHA të auditimit të Malit të Zi për 19-vjetorin e themelimit



Takimi i krerëve të Institucioneve Supreme të Auditimit me presidentin e Malit të Zi



Takimi i AP-së me AP-në e Suedisë gjatë vizitës bilaterale në Stokholm

Përfaqësuesit e ZKA-së gjatë vitit 2023 kanë marrë pjesë edhe në konferenca, punëtori e takime ndërkombëtare si:

- Webinarin “Menaxhimi i Cilësisë për Institucionet Supreme të Auditimit”;
- Takimin vjetor të anëtarëve të nëngrupit për e-Qeverisje nga Grupi punues për Teknologji të Informacionit në EUROSAI (ITWG);
- Tryezën “Bashkëpunimi me shoqërinë civile për të përmirësuar kuptimin dhe ndikimin e Institucioneve Supreme të Auditimit”;

- Webinarin “Auditimi i Teknologjisë së Informacionit dhe Sistemi i Menaxhimit të Auditimit – SITA në Zyrën Kombëtare të Auditimit të Kosovës”;
- Takimin e grupit punues për zhvillimin e Manualit Aktiv të Auditimit të TI-së mbështetur nga Hapësira e Kontrollit të e-Qeverisjes;
- Takimin e zyrtarëve ndërlidhës të Rrjetit të Institucioneve Supreme të Auditimit të vendeve kandidatë dhe kandidatë të mundshme për anëtarësim në Bashkimin Evropian dhe takimin e Komitetit të Kontaktit;
- Shkollën Verore të EUROSAT-t për auditime investigative;
- Forumin “WORKING TOGETHER”;
- Punëtorinë “Auditimi i së ardhmes së barabartë”;
- Takimin vjetor të Task Forcës së EUROSAT-t për auditimin e komunave;
- Punëtorinë e programit “LOTA Pioneers” si dhe
- Përfaqësuesit e ZKA-së kanë zhvilluar vizitë studimore në Zyrën Kombëtare të Auditimit në Estoni.

Aktivitetet në kuadër të grupeve punuese dhe task forcave të INTOSAI-t dhe EUROSA-t kanë vazhduar edhe gjatë vitit 2023. Përfaqësuesit e ZKA-së kanë dhënë kontributin e tyre në grupet punuese si Task Forca e EUROSAT-t për auditimin e Komunave dhe Grupin Punues i EUROSAT-t për auditimet e TI-së.

Poashtu gjatë vitit 2023, ZKA-ja është anëtarësuar në:

- Taskë Forcës së INTOSAI-t për përfshirjen e qytetarëve dhe shoqërisë civile në proceset e auditimit;
- Projekt Grupin e EUROSAT për mbështetjen e Institucionit Suprem të Auditimit të Ukrainës;
- Projekt Grupin e EUROSAT-t për metodologjinë dhe përfitimet nga auditimi në kohë reale.

Ndër partnerët kryesor të ZKA-së në sferën e bashkëpunimit ndërkombëtar është edhe Iniciativa për Zhvillim e INTOSAI-t (IDI). Gjatë vitit 2023, auditorë të ZKA-së kanë ndjekur trajnime e webinare profesionale të organizuara nga kjo organizatë. Dy auditorë kanë përmbushur me sukses programin “Edukimi Profesional për

Auditor” dhe janë pajisur me certifikatë. Me qëllim të përfitimit të zhvillimit profesional, ZKA-ja ka shqyrtuar me kujdes programet profesionale të ofruara nga IDI dhe gjatë vitit 2023 auditorë tanë me sukses janë bërë pjesë e:

- Programit dyvjeçar “Pionierët duke Përdorur Avancimin e Teknologjisë (LOTA Pioneers)”;
- Programit “Edukimi Profesional për Auditorë (PESA)” dhe
- Programit “Auditimi i të Ardhmes së Barabartë (EFA)”.

ZKA-ja ka vazhduar bashkëpunimin edhe me partnerët tjerë ndërkombëtar që operojnë në vend si me Zyrën e Bashkimit Evropian në Kosovë, Organizatën për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, Zyrën e UN-Women në Kosovë, USAID, Helvetas, etj.

Projekti “Bashkëpunimi për Zhvillim Institucional me Zyrën Kombëtare të Auditimit të Kosovës 2020-2023”. Edhe gjatë vitit 2023 ka vazhduar zbatimin i marrëveshjes së bashkëpunimit bilateral në mes Zyrës Kombëtare të Auditimit të Suedisë dhe Zyrës Kombëtare të Auditimit të Kosovës. Aktivitetet në kuadër të projektit janë realizuar në nivel të kënaqshëm duke ju përmbajtur planit të punës. Auditorja e Përgjithshme Vlora Spanca, me bashkëpunëtorë në dhjetor të vitit 2023 kanë realizuar vizitë pune në Zyrën Kombëtare të Auditimit të Suedisë. Qëllimi i vizitës ishte nënshkrimi i marrëveshjes për vazhdimin e bashkëpunimit bilateral edhe për një vit, përkatësisht nga 1 janar 2024 deri më 31 dhjetor 2024. Marrëveshja është nënshkruar nga Auditorja e Përgjithshme e Suedisë Helena Lindberg dhe Auditorja e Përgjithshme e Kosovës Vlora Spanca. Palët janë pajtuar që të gjitha dispozitat e tjera të Memorandumit të Mirëkuptimit mbeten të pandryshuara, në fuqi dhe të zbatueshme në plotësi.

